



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.5.2022, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Raporti vjetor i Bankës së Shqipërisë për veprimtarinë e vjetore të vitit 2021.

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Sorina Koti, Jorida Tabaku Arbi Agalliu, Emilja Koliqi, Erion Braçe, Alban Xhelili, Vullnet Sinaj, Antoneta Dhima, Shpresa Marnoj, Edmond Spaho, Bujar Leskaj, Enslemvera Zake, Blerina Gjylameti, Pranvera Resulaj, Benet Beci, Agron Shehi dhe Dashamir Shehi.

Mungojnë:

Alfred Rushaj, Benet Beci dhe Agron Shehaj.

Të ftuar

Gent Sejko – Guvernator i Bankës së Shqipërisë

Erald Themeli - Drejtor i Politikës Monetare në Bankën e Shqipërisë

Deniz Deralla - Drejtor i Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë

Donald Duraj - Shefi i Kabinetit të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi - Mirëmëngjesi, të nderuar kolegë deputetë!

Verifikojmë kuorumin para se të hapim mbledhjen. Kuorumi është në rregull.

Media, mund të futet brenda.

Mbledhjen e deklaroj të hapur.

Sot në rendin e ditës kemi raportin vjetor të Bankës së Shqipërisë për veprimtarinë e vjetore të vitit 2021.

Të ftuar kemi Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, zotin Gent Sejko, i cili shoqërohet nga zoti Erald Themel, drejtor i Politikës Monetare, zoti Deniz Deralla, drejtor i Mbikëqyrjes, dhe zoti Donald Duraj, shefi i kabinetit të Guvernatorit.

Para se t'i jap fjalën Guvernatorit, të cilit bashkë me stafin e tij i uroj mirëseardhjen në komision, dua të theksoj se për këtë çështje kemi dy relatorë: zonjën Pranvera Resulaj dhe zonjën Jorida Tabaku, në vijim të një vendimi që kemi marrë bashkërisht për të caktuar dy relatorë për institucionet e pavarura.

Fjalën e ka zoti Sejko për të prezantuar veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë për vitin 2021. Pastaj respektivisht fjalën e kanë relatorët përpara se të kalojmë në fazën e pyetjeve. Në një mbledhje tjetër në vijim do të miratojmë edhe rezolutën, një draft, të cilin po e shpërndajmë. A jeni dakord me rendin? Në rregull.

Zoti Sejko, fjala për ju.

Gent Sejko – Faleminderit!

I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Në fillim, më lejoni t'ju falënderoj për vlerësimin që më dhatë, duke më besuar një mandat të dytë, si Guvernator i Bankës së Shqipërisë. Ju siguroj se llogaridhënia dhe dialogu konstruktiv midis institucioneve tona do të vazhdojë edhe në të ardhmen me të njëjtën frymë si deri tani.

Sot në fjalën time, do t'ju paraqes punën dhe rezultatet e Bankës së Shqipërisë gjatë vitit të shkuar, si në drejtim të përmbushjes së detyrave të saj ligjore, ashtu dhe në drejtim të respektimit të rezolutës së Kuvendit për veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë për vitin 2020 dhe

të jetësimit të angazhimeve të saj institucionale. Megjithatë, duke përfituar nga kjo mundësi, dëshiroj të ndaj me ju edhe këndvështrimin tonë mbi sfidat me të cilat po përballemi në realitetin e ri ekonomik, të shkaktuar nga sulmi ushtarak i Rusisë ndaj Ukrainës. Ky zhvillim ka sjellë një rritje galopante të çmimeve të produkteve bazë në tregjet botërore, duke shtrenjtuar kostot e jetesës së familjeve dhe duke rritur kostot e prodhimit të bizneseve. Për më tepër, konflikti i armatosur ka shtuar pasiguritë dhe ka krijuar pengesa të reja në zinxhirët e furnizimit, të cilët po ndikohen edhe nga kufizimet e vendosura rishtas ndaj valëve të reja të pandemisë në Azi. Kjo goditje me ndikim të dyfishtë në rritje për çmimet dhe në rënie për aktivitetin ekonomik do të transmetohet edhe në ekonominë shqiptare. Ajo pritet të sjellë norma më të larta inflacioni dhe rritje më të ngadaltë ekonomike në Shqipëri krahasuar me vlerësimet tona përpara fillimit të luftës.

Megjithatë, trendi pozitiv i zhvillimit ekonomik të vendit pritet të mbetet i pacenuar në afatin e mesëm dhe të gjatë. Bazuar në informacionin aktual, ne presim që ekonomia të vijojë të rritet gjatë vitit 2022 dhe në vijim. Ky gjykim mbështetet në gjerësinë dhe fortësinë e burimeve të rritjes, në ekuilibrat e konsoliduar ekonomikë dhe financiarë, si dhe në vijimin e një miksi stimulues politikash monetare e fiskale. Nga ana tjetër, ne parashikojmë që inflacioni të mbetet në nivele relativisht të larta gjatë vitit 2022. Më tej, ai pritet të vijë në rënie gjatë vitit 2023, në linjë me reduktimin e pritur të presioneve në tregjet botërore, dhe të kthehet në objektiv në gjysmën e parë të vitit 2024. Këto projeksione mbështeten në tre konsiderata të rëndësishme.

Së pari, ato supozojnë mospërshkallëzimin e konfliktit dhe vijimin e rritjes në partnerët tanë tregtarë.

Së dyti, ato faktorizojnë bazat solide në të cilat ndodhet ekonomia shqiptare pas rimëkëmbjes së gjithanshme të vitit 2021. Në mënyrë të përmbledhur, më lejoni të theksoj se ekonomia shqiptare e mbylli vitin 2021 me parametra të përmirësuar ekonomikë e financiarë. Vëllimi i aktivitetit ekonomik u rrit, punësimi u zgjerua dhe rritja e pagave u përshpejtua. Në tërësi, bilancet e sektorit privat u përmirësuan, stabiliteti monetar dhe financiar i vendit u konsolidua, dhe tregjet financiare funksionuan normalisht. Në veçanti, sektori bankar ruajti tregues të mirë likuiditeti, kapitalizimi dhe rentabiliteti.

Së treti, ato kërkojnë rishikimin e vazhdueshëm të miksit të politikave ekonomike. Në gjykimin e Bankës së Shqipërisë, këto politika duhet të vijojnë të ofrojnë mbështetje për procesin e rimëkëmbjes, por pa paragjykuar për asnjë moment stabilitetin monetar dhe financiar të vendit.

Ky stabilitet ka qenë dhe mbetet një parakusht për zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë dhe rritjen e mirëqenies së shoqërisë.

Përmbushja e këtij objektivi sot, ndryshe nga më parë, kërkon adresimin e rreziqeve për rritjen e inflacionit.

Nisur nga sa më sipër, politika monetare e Bankës së Shqipërisë do të vijojë të udhëhiqet nga respektimi i objektivit të saj parësor dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Në këtë frymë, ne vendosëm të rrisim normën bazë të interesit në muajin mars, duke e kthyer atë në nivelin e para pandemisë prej 1%.

Nga ana tjetër, politika fiskale duhet të vijojë të ofrojë mbështetje financiare për shtresat me të ardhura të ulëta të shoqërisë dhe për sektorët më të ekspozuar ndaj goditjes. Megjithatë, kjo mbështetje duhet të financohet nga të ardhurat shtesë të siguruara nga rritja e çmimeve dhe nga rishikimi i shpenzimeve joprioritare. Në këtë mënyrë, efektiviteti i ndërhyrjes nuk do të dëmtojë treguesit e borxhit publik.

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Konflikti ka shtuar pasiguritë për të ardhmen. Shkalla e ndikimit të tij do të varet nga kohëzgjatja e konfliktit dhe shtrëngimi potencial i sanksioneve ndaj Rusisë. Ne jemi të ndërgjegjshëm se rreziqet ndaj inflacionit janë të përqendruara për lart dhe ato ndaj rritjes ekonomike për poshtë. Në këtë mjedis ekonomik kompleks, roli i politikave monetare dhe fiskale mbetet kritik. Banka e Shqipërisë do të vijojë të monitorojë ecurinë e inflacionit dhe nuk do të hezitojë të reagojë, në kohën dhe me forcën e duhur, për të garantuar stabilitetin monetar dhe financiar të vendit. Kursi i politikës monetare pritet të fillojë rrugën e normalizimit gradual gjatë vitit 2022. Ky qëndrim ofron një balancë të përshtatshme midis rrezikut të përshpejtimit të inflacionit dhe rrezikut të ngadalësimit të rritjes ekonomike.

Në vijim të fjalës sime do të ndalem shkurtimisht në drejtimet kryesore të punës sonë gjatë vitit 2021 dhe rezultatet e saj.

Së pari, ecuria ekonomike dhe politika monetare e Bankës së Shqipërisë. Sikurse thashë ekonomia shqiptare u rimëkëmb me hapa të shpejtë gjatë vitit 2021. Sipas të dhënave të Institutit të Statistikave, prodhimi i brendshëm bruto u rrit me 8,5%, pas tkurrjes me 3.5% gjatë vitit 2020. Rritja e shpejtë ekonomike pasqyroi reduktimin e masave kufizuese, rritjen e besimit, përmirësimin e ambientit të huaj, si dhe stimujt monetarë dhe fiskalë. Këta faktorë i hapën rrugë zgjerimit të shpejtë të kërkesës për mallra e shërbime. Rimëkëmbja e shpejtë ekonomike pati disa

karakteristika, të cilat ilustruan fleksibilitetin e ekonomisë sonë dhe janë premisa inkurajuese për rritjen e qëndrueshme të ekonomisë në vijim.

Më lejoni të ndalem në disa prej tyre:

Rimëkëmbja ishte me bazë të gjerë. Në terma të kërkesës agregate, ajo pasqyroi rritjen e konsumit dhe të investimeve private, zgjerimin e eksporteve të mallrave e të shërbimeve, si dhe kontributin pozitiv të stimullit fiskal. Në terma sektorialë, ajo pasqyroi zgjerimin e të gjithë sektorëve të ekonomisë.

Rimëkëmbja u shoqërua me rritje të punësimit dhe të pagave, duke përmirësuar bilancet financiare të familjeve. Rritja e punësimit mundësoi rënien e shkallës së papunësisë në 11,4% në fund të vitit, duke qëndruar pranë niveleve të parakrizës, në reflektim të tyre, pagat njohën ritme të larta rritjeje, në thuajse të gjithë sektorët e ekonomisë. Rimëkëmbja ishte e plotë. Si ekonomia në tërësi, ashtu dhe sektorët e saj individualë në veçanti, kanë tejkaluar nivelet e prodhimit dhe të të ardhurave që siguronin në periudhën para pandemisë dhe tërmetit të vitit 2019. Ky zhvillim ilustron rikuperimin e shpejtë të kërkesës dhe ndikimin e pakët strukturor që këto goditje patën në strukturën prodhuese të ekonomisë.

Rimëkëmbja pasqyroi kontributin pozitiv të të gjithë sektorëve ekonomikë.

Së pari, përgjigjja e bizneseve dhe familjeve tregoi se ata gëzonin si bilance relativisht solide, ashtu edhe fleksibilitet e gatishmëri për t'iu rikthyer sjelljes së tyre normale ekonomike.

Së dyti, përgjigjja e autoriteteve publike ishte e shpejtë, e përshtatshme dhe efikase, çka lehtësoi barrën financiare të goditjes mbi bizneset dhe familjet shqiptare, duke i hapur rrugë rimëkëmbjes. Së treti, sektori bankar vijoi të financojë zgjerimin e konsumit dhe të investimeve, duke përmirësuar në të njëjtën kohë treguesit e tij të fitimit dhe të likuiditetit.

Së fundi, por jo më pak e rëndësishme, rimëkëmbja u shoqërua me përmirësim të ekuilibrave ekonomikë e financiarë të vendit. Pozicioni i huaj dhe ai fiskal i vendit u përmirësua dhe treguesit kryesorë të shëndetit financiar u konsoliduan. Deficiti i llogarisë korrente zbriti në një nivel mesatar prej 7,7% të PBB-së gjatë vitit 2021, kundrejt nivelit 8,7% të regjistruar një vit më parë. Në sferën fiskale, kombinimi i rritjes ekonomike me rënien e deficitit buxhetor ndihmoi rënien e raportit të borxhit publik ndaj PBB-së në 73,2%, nga 74,5% të regjistruar në vitin 2020.

Rritja progresive e kërkesës për mallra dhe shërbime mundësoi rritjen e punësimit, të pagave dhe të marzheve të fitimit, duke u pasqyruar në një trend rritës të inflacionit në linjë me

objektivin tonë. Inflacioni mesatar rezultoi në nivelin 2% në vitin 2021, kundrejt vlerës 1,6% të një viti më parë.

Nga ana tjetër, rritja e shpejtë e çmimeve në tregun ndërkombëtar e shtyu inflacionin në nivelin 3,7% në muajin dhjetor 2021 dhe 5,7% në muajin mars 2022, si dhe në muajin prill në 6,2%.

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Pa ju marrë shumë kohë, më lejoni të ndalem tek roli që ka luajtur Banka e Shqipërisë në procesin e rimëkëmbjes, si në drejtim të rritjes ekonomike, ashtu dhe në atë të ruajtjes së stabilitetit monetar e financiar. Politika monetare vijoi të mbetet në kahun stimulues edhe gjatë vitit 2021. Norma bazë e interesit mbeti në nivelet e veta më të ulëta historike, prej 0,5%, ndërsa vëllimi i likuiditetit të injektuar në sistem u rrit gjatë vitit 2021. Paralelisht me to, Banka e Shqipërisë vijoi të orientojë tregun mbi kahun e politikës monetare në të ardhmen, duke reduktuar pasigurinë në tregjet financiare.

Kursi stimulues i politikës monetare siguroi një ambient me kosto të ulëta financimi dhe kushte të përshtatshme kreditimi. Tregjet financiare funksionuan normalisht dhe u karakterizuan nga likuiditeti i bollshëm dhe prime të ulëta rreziku. Transmetimi efektiv i stimulit monetar ka mbajtur në nivele të ulëta normat e interesit të kredisë për sektorin privat dhe atë publik. Po ashtu, kursi i këmbimit ishte relativisht i qëndrueshëm, në pasqyrim të balancës së kërkesës dhe ofertës për valutë.

Ky ambient mundësoi një rritje të qëndrueshme të kredisë. Vëllimi i kredisë për sektorin privat u rrit mesatarisht me 8,4% gjatë vitit 2021 norma më e lartë e rritjes prej vitit 2012. Përtej rritjes së përgjithshme të portofolit, dinamikat e kreditimit mbartën sinjale të tjera pozitive.

Së pari, rritja e portofolit të kredisë shkoi më së shumti për financimin e investimeve të bizneseve dhe për kredi hipotekore, duke sinjalizuar rritjen e investimeve të sektorit privat dhe një situatë në përmirësim të likuiditetit të tij.

Së dyti, kredia në monedhën vendase vijoi të ruajë norma të larta rritjeje, duke u reflektuar në rritjen progresive të peshës së kredisë në lekë ndaj totalit. Ky zhvillim krijon premisa për një përcjellje më të mirë të stimulit monetar dhe një rezistencë më të lartë të sistemit bankar ndaj rreziqeve.

Së treti, cilësia e portofolit të kredisë për sektorin privat erdhi drejt përmirësimit, sikundër ilustron nga rënia progresive e treguesit të kredisë me probleme. Vlerësimet tona

empirike tregojnë se kursi stimulues i politikës monetare ka kontribuar me rreth 1,3 pikë përqindje në rritjen ekonomike të vitit 2021. Ky kontribut vjen si rezultat i normave të ulëta të interesit, i primeve të ulëta të rrezikut, i kreditimit të vazhdueshëm të ekonomisë dhe i rritjes së konkurrencës së eksporteve shqiptare. Nëpërmjet nxitjes së kërkesës agregate dhe shfrytëzimit më të mirë të potencialeve prodhuese, stimuli monetar ka kontribuar pozitivisht në stabilitetin e çmimeve.

Më lejoni tani të ndalem në çështjet e stabilitetit financiar dhe të mbikëqyrjes e rregullimit bankar.

Mbikëqyrja bankare dhe stabiliteti financiar gjatë vitit 2021.

Sistemi bankar u karakterizua nga një ecuri pozitive gjatë vitit 2021. Gjatë periudhës së pandemisë, sistemi bankar tregoi se ishte një partner serioz në mbështetjen e zhvillimit ekonomik të vendit, duke marr përsipër një pjesë të barrës së kostove. Viti 2021 konfirmoi se ky sektor ka aftësi të larta rezistence, falë politikave makroprudenciale të Bankës së Shqipërisë, zbatimit të një kuadri të shëndoshë mbikëqyrjeje dhe përmirësimit të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të bankave. Veprimtaria financiare e sistemit bankar ishte e qëndrueshme, investimet e tyre janë zgjeruar, cilësia e portofolit të aktiveve është përmirësuar dhe normat e fitimit kanë njohur rritje. Rezultati financiar ishte pozitiv dhe rreth 29% më i lartë nga një vit më parë; niveli i mjaftueshmërisë së kapitalit mbeti në nivelin mbi 18% dhe ndjeshëm mbi limitin rregullator; sikurse edhe treguesi i kredive me probleme zbriti në nivelin 5,6% në fund të vitit, nga 8,1% një vit më parë, duke shënuar dhe normën më të ulët të dekadës së fundit. Aktualisht treguesi i kredive me probleme ka zbritur dhe më poshtë në nivelin e 5,2%. Ekspozimi i aktivitetit të sektorit bankar ndaj rreziqeve mbetet i kontrolluar. Ushtrimet e provës së rezistencës tregojnë se aftësia e sektorit bankar për të përballuar humbjet që burojnë nga materializimi i goditjeve të pafavorshme në sektorin real dhe financiar mbetet e fortë. Këto rezultate pozitive nuk kanë ulur vëmendjen tonë ndaj forcimit të mbikëqyrjes së bankave dhe përmirësimit të kuadrit makroprudencial. Më poshtë, do të rendis shkurtimisht disa nga prioritetet e punës së Bankës së Shqipërisë në këtë drejtim.

Së pari, çelja e procesit të ekuivalentimit të kuadrit tonë mbikëqyrës e rregullator me atë të BE-së. Ky proces synon të certifikojë shkallën e konvergencës së kuadrit tonë rregullator dhe të praktikave tona mbikëqyrëse me ato të Bashkimit Europian. Me asistencën teknike të ekspertëve ndërkombëtare, gjatë vitit 2021 u krye një vlerësim i pavarur i kuadrit mbikëqyrës në

vend, i cili konkludoi se Shqipëria gëzon një nivel të lartë ekuivalence me standardet e Bashkimit Evropian. Tashmë, Banka e Shqipërisë ka kërkuar pranë Komisionit European nisjen e procesit formal të ekuivalencës. Zbatimi i rekomandimeve të Komitetit të MONEYVAL, në kuadër të masave kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Banka e Shqipërisë është e përfshirë në planin kombëtar të masave për parandalimin e pastrimit të parasë dhe të financimit të terrorizmit, duke pasur përgjegjësi për përmirësimin e kuadrit rregullator dhe forcimin e efektivitetit të procesit mbikëqyrës. Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë ka vijuar inspektimet në vend për çështje që lidhen me parandalimin e pastrimit të parave, me një fokus të veçantë në çështjet e financimit të terrorizmit dhe të zbatimit të sanksioneve ndërkombëtare. Inspektimet kanë targetuar bankat, subjektet financiare jobanka dhe zyrat e këmbimit valutor.

Përmirësimi i kuadrit rregullator për rritjen e transparencës dhe mbrojtjen e konsumatorit. Duke parë përshpejtimin e kreditimit të konsumatorëve, veçanërisht nga subjektet financiare jobanka, Banka e Shqipërisë ndërmoi një iniciativë për forcimin e kuadrit rregullator për kreditë konsumatore, me qëllim mbrojtjen e konsumatorit nga vendosja e normave të larta dhe të pajustificuara të interesit për këto kredi. Ndryshimet prezantojnë për herë të parë konceptin e një kufiri maksimal të lejuar të normës efektive të interesit dhe të penalteteve që zbatohen për klientët e kredive konsumatore. Për realizimin e këtyre ndryshimeve, u ndoqën praktikat më të mira nga vendet e Bashkimit Evropian. Ndryshime janë bërë edhe në kuadër të transparencës së produkteve bankare, ku me procesin gradual të zëvendësimit të referencës për normat e interesit të produkteve bankare, siç janë LIBOR, EURIBOR e të tjera, bankat duhet të rrisin shkallën e informimit për huamarrësit. Ndryshimet e miratuara në rregulloren përkatëse, e konturojnë këtë informim me baza ligjore në marrëdhëniet kontraktuale.

Një tjetër çështje: përafrimi rregullator e metodologjik me standardet ndërkombëtare. Banka e Shqipërisë ka vijuar punën për përmirësimin e kuadrit rregullator mbikëqyrës, me synim përafrimin e tij me *acquis* të BE-së, parimet e Komitetit të Bazelit dhe me praktikat më të mira të mbikëqyrjes bankare.

Rishikimi i rregulloreve ka pasur në fokus përshtatjen me rregulloret më aktuale të BE-së, të cilat synojnë të vlerësojnë aftësitë për administrimin e likuiditetit të bankave; krijimin e shtesave në kapital për të mbrojtur bankat nga ekspozimet për rreziqe të ndryshme e të tjera. Gjithashtu, një pjesë e rëndësishme e akteve nënligjore janë hartuar dhe miratuar për të plotësuar

kuadrin rregullator për zbatimin e ligjit “Për shërbimet e pagesave” dhe atë për ligjin “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë”.

Monitorimi rigoroz i sistemit financiar nëpërmjet inspektimeve në vend. Inspektimet në vend kanë vijuar rregullisht, ku janë shtuar ekzaminimet e subjekteve financiare jobanka dhe të zyrave të këmbimit valutor. Fokusi i ekzaminimeve në banka ka qenë vlerësimi i administrimit të situatës së pandemisë dhe ndikimit në portofolin e kredisë. Bankat kanë ndjekur një qasje të kujdesshme në kreditim, të mbështetur në kriteret e caktuara për ofrimin e lehtësirave për klientët me probleme. Krahas fokusit kryesor tek rreziku i kredisë, ekzaminimet kanë vlerësuar dhe profilin e rreziqeve të tjera që lidhen me veprimtarinë bankare, si rreziku operacional dhe i teknologjisë së informacionit, rreziqe financiare e të tjera, për të cilat janë dhënë rekomandimet përkatëse.

Fuqizimi i aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme.

Gjatë vitit 2021 ka përfunduar hartimi i planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të të gjitha bankave që operojnë në tregun shqiptar, si dhe janë identifikuar pengesat potenciale ndaj aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme. Në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, janë përcaktuar dhe kërkesat minimale të instrumenteve që duhet të mbajnë bankat në çdo kohë, me qëllim mundësimin e zbatimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Zhvillimi dhe zbatimi i politikës makroprudenciale në funksion të ruajtjes së stabilitetit financiar. Gjatë vitit 2021, vijoi zbatimi i masave që synojnë uljen e përdorimit të valutave në veprimtarinë e sektorit bankar dhe zbatimi i shtesave makroprudenciale të kapitalit. Zhvillimet gjatë vitit nuk kanë kërkuar ndërhyrje me masa shtesë të natyrës makroprudenciale. Megjithatë, përdorimi i valutave mbetet ende në nivele të larta dhe kërkon vëmendje më të madhe nga autoritetet e tjera ligjzbatuese në vend.

Krahas rolit të saj primar në ruajtjen e stabilitetit monetar e financiar, Banka e Shqipërisë është përgjegjëse për një sërë detyrash e veprimtarish, të cilat, për hir të kohës, do të më duhet t'i përmend fare shkurt.

Aktivitete të tjera.

Garantimi i sistemeve të pagesave të sigurta dhe eficiente në republikën e Shqipërisë. Banka e Shqipërisë operon me dy sisteme pagesash në lekë, atë për pagesat me vlerë të vogël (AECH) dhe atë për pagesat me vlerë të madhe (AIPS). Të dy sistemet kanë treguar

disponueshmëri maksimale dhe kanë funksionuar në mënyrë të sigurt, duke garantuar rrjedhjen e fondeve për ekonominë. Me synimin për të plotësuar dhe modernizuar infrastrukturën e pagesave në vend, Banka e Shqipërisë ka përfunduar projektin për ofrimin e një sistemi të ri të shlyerjes së pagesave kombëtare në monedhën euro për klientët e bankave, AIPS në euro. Ky sistem ka filluar operimin në janar të vitit 2022, duke u mundësuar qytetarëve shqiptarë kryerjen e pagesave në euro brenda vendit, me kosto shumë më të ulëta dhe në një afat kohor shumë më të shkurtër krahasuar me procesin e mëparshëm nëpërmjet bankave korrespondente. Gjithashtu, me qëllim rritjen e përfshirjes financiare dhe të përdorimit të pagesave elektronike, gjatë vitit 2021, u bë i mundur zbatimi i skemës së debitimit direkt ndërbankar, sipas standardeve të bashkimit Europian, SEPA, e cila i krijon konsumatorëve fleksibilitet në kryerjen e pagesave për shërbimet utilitare nëpërmjet sistemit bankar, pavarësisht insitucionit financiar ku kanë llogarinë e pagesës.

Nxjtja e pagesave elektronike dhe e përfshirjes financiare të popullsisë. Numri i pagesave elektronike të kryera në vend u rrit me 29,5% gjatë vitit 2021. Rritja e tyre është ndihmuar nga ndryshimet rregullatore nëpërmjet ligjit “Për shërbimet e pagesave”, si dhe nga përmirësimet në infrastrukturë. Përdorimi i pagesave elektronike në vit për individë në moshë madhore arriti në nivelin 12,5 në fund të vitit 2021, kundrejt 4,3 që ishte në vitin 2017. Zhvillime pozitive janë shënuar dhe në zgjerimin e përqindjes së popullsisë, e cila zotëron një llogari pagesash. Në vitin 2021 rezulton se rreth 69% e popullsisë në moshë madhore zotëron një llogari pagese, kundrejt vetëm 40% të popullsisë që zotëronte një llogari pagese në vitin 2017.

Përmirësimi i kuadrit rregullator të sistemeve të pagesave në përputhje me standardet e Bashkimit Europian. Gjatë vitit 2021 është hartuar projektligji “Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike”, në përputhje me direktivat e BE-së. Miratimi i tij ofron shërbime financiare bazike për individët e pambuluar me shërbime bankare, pavarësisht nivelit të të ardhurave, statusit të punësimit, apo historikut të aftësisë paguese.

Emetimi i kartëmonedhës. Siguria fizike e saj dhe miradministrimi i parasë fizike përbën një drejtim tjetër të rëndësishëm të veprimtarisë sonë. Në këtë drejtim, në muajin qershor të vitit 2021, u nënshkrua me Bankën Qendrore Europiane në një marrëveshje për mbrojtjen e kartëmonedhës euro nga falsifikimi, duke e bërë kështu Bankën e Shqipërisë pjesë integrale të procesit europian në luftën kundër falsifikimit të kartëmonedhave. Po ashtu, ne kemi realizuar përfundimisht kompletimin e serisë sonë të re të kartëmonedhave, të përbërë nga 6 prerje. Në

muajin dhjetor të vitit 2021 u hodhën në qarkullim edhe dy prerjet e fundit të kësaj serie, ato 500 dhe 2,000 lekë, ndërkohë që në qershor 2021, tregut i ishte shtuar edhe kartëmonedha me prerjen më të madhe në vlerën 10,000 lekë, e cila përbën edhe një risi në procesin e prodhimit të parasë sonë. Kartëmonedhat e serisë së re janë dizenuar dhe prodhuar me teknologjinë më të fundit të fushës dhe janë të pajisura me elemente bashkëkohore dhe të sofistikuara sigurie.

Përmbushja e detyrimeve institucionale në kuadër të integritit europian. Banka e Shqipërisë ka një rol esencial në arritjen e qëllimit kombëtar për aderimin në Bashkimin Europian. Ajo është udhëheqëse në një kapitull të përputhshmërisë së legjislacionit, ndërsa është anëtare e grupeve të punës për kapituj të tjerë. Banka e Shqipërisë ka realizuar miratimin e akteve nënligjore të parashikuara në Planin Kombëtar të Integritit Europian dhe ka përfshirë në prioritetet e punës së saj rekomandimet e Komisionit Europian.

Rritja e komunikimit, transparencës dhe llogaridhënies. Banka e Shqipërisë mbetet një institucion i hapur, i gatshëm të komunikojë me transparencë vendimet e saj dhe të përgjigjet me seriozitet për veprimtarinë e saj. Gjatë vitit 2021 ka vijuar komunikimi fizik dhe virtual me median, akademikë, publikun e gjerë dhe palë të interesuara. Vitet e fundit Banka e Shqipërisë ka marrë përgjegjësi publike për ndërmarrjen e fushatave për edukimin financiar. Në bashkëpunim edhe me Shoqatën e Bankave janë kryer disa aktivitete, me qëllim rritjen e njohurive financiare të publikut dhe rritjen e ndërgjegjësimit për financat personale. Paralelisht me to, Banka e Shqipërisë ka shënuar progres të mëtejshëm në fushën e administrimit të rezervës valutore, në fushën e kërkimit shkencor, në proceset e mbledhjes, hartimit dhe raportimit të statistikave, si dhe në drejtim të forcimit të qeverisjes së institucionit. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë ka përmbushur rekomandimet e lëna nga Kuvendi i Shqipërisë për aktivitetin e saj gjatë vitit 2020.

Një informacion të gjerë për këto çështje do ta gjeni të detajuar në faqet e raportit vjetor 2021.

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Duke ju falënderuar për vëmendjen, më lejoni të theksoj se Banka e Shqipërisë ka qenë dhe mbetet e angazhuar për respektimin e detyrave të saj ligjore, për adresimin e sfidave të rritjes, si dhe për ndërtimin e një dialogu konstruktiv me të gjithë aktorët dhe faktorët e jetës ekonomike dhe sociale në vend.

Kuvendi i Shqipërisë dhe publiku shqiptar do të gjejë të Banka e Shqipërisë një partner serioz në rrugën e zhvillimit të vendit.

Ju faleminderit për vëmendjen!

Eduard Shalsi - Faleminderit, zoti Guvernator!

Fjalën e ka relatorja, zonja Resulaj, pastaj zonja Tabaku.

Pranvera Resulaj - I nderuar zoti kryetar,

I nderuar zoti Guvernator,

Të nderuar kolegë,

Banka e Shqipërisë është një nga autoritetet publike më të rëndësishme për jetën ekonomike të vendit tonë. Nëpërmjet garantimit të stabilitetit monetar e financiar, ajo kontribuon në rritjen e qëndrueshme dhe afatgjatë të ekonomisë, të punësimit dhe të mirëqenies së shtetasve shqiptarë.

Pavarësisht sfidave e vështirësive, si dhe realiteteve të reja të krijuara nga së fundmi nga lufta në Ukrainë, Banka e Shqipërisë ka arritur të përmbushë plotësisht funksionet e saj, duke amortizuar goditjet në ekonominë tonë dhe në tregun financiar. Kjo është bërë e mundur falë nivelit të lartë të profesionalizimit, vlerave dhe qasjes së Bankës për të qenë gjithmonë e përgatitur ndaj situatave të panjohura.

Raporti vjetor për vitin 2021, duke siguruar një përmbledhje të aktivitetit, sikundër edhe ju zoti guvernator e thatë në relacionin tuaj, dhe rezultateve të punës së Bankës së Shqipërisë, dokumenton edhe një herë këtë filozofi. Pa rënë në përsëritje, e shoh me interes të ritheksoj edhe njëherë punën e bërë nga Banka dhe kontributin e dhënë në ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe në promovimin e stabilitetit financiar të vendit.

Politika monetare stimuluese e Bankës së Shqipërisë luajti një rol të rëndësishëm në mbështetjen dhe rimëkëmbjen e aktivitetit ekonomik të vendit pas dy goditjeve të njëpasnjëshme, atë tërmetit dhe pandemisë. Në gjykim tim, vendimet e Bankës kanë qenë në kohën dhe intensitetin e duhur, si dhe në koordinim të plotë me masat makroprudenciale dhe kahun e politikës fiskale, e cila, sikurse e dimë, akomodohet më shpejt se politika monetare. Ato kanë kontribuar në funksionimin normal të tregjeve financiare, në uljen e kostove të financimit dhe në kreditimin e pandërprerë të ekonomisë. Paralelisht me politikën monetare stimuluese, forcimi i mbikëqyrjes bankare dhe masat makroprudenciale kontribuuan në garantimin e stabilitetit financiar. Sektori financiar paraqitet i qëndrueshëm. Në veçanti, sektori bankar vijoi të zgjerojë veprimtarinë, duke mbetur njëherazi likuid dhe i mirëkapitalizuar. Të gjithë treguesit kryesorë të veprimtarisë bankare shënuan përmirësim gjatë vitit 2021, ku spikat përmirësimi i cilësisë së

portofolit të kredisë. Raporti i kredive me probleme shënoi nivelin më të ulët që prej krizës financiare të vitit 2008, megjithatë duhet theksuar që është ende nën nivelin mesatar të rajonit. Po ashtu, rreziqet e veprimtarisë bankare paraqiten të kontrolluara.

Mbikëqyrja e aktivitetit bankar, rregullimi dhe licencimi i tij, përfshirë subjektet financiare jo-banka dhe zyrat e këmbimit valutor është bazuar në praktika të konsoliduara të administrimit të rrezikut dhe është realizuar nëpërmjet inspektimeve në vend dhe analizave të bilanceve e të raporteve financiare.

Përafrimi i kuadrit mbikëqyrës dhe rregullator me direktivat europiane dhe standardet e Komitetit të Bazelit ka synuar rritjen e transparencës në shërbimet bankare, mbrojtjen e konsumatorit, politikat për ruajtjen e treguesve të shëndetit të bankave, e të tjerë. Paralelisht me to, Banka ka investuar për përmirësimin e kuadrit rregullator, përmirësimin e procesit mbikëqyrës, si dhe rritjen e dialogut me institucionet, si: Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe AMF-në në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Dëshiroj të eidentoj si një arritje pozitive konkluzionet e analizës nga vlerësimi paraprak i ekuivalencës së kuadrit mbikëqyrës rregullativ shqiptar me standardet e Autoriteti Bankar Europian. Ky vlerësim tregon se kuadri rregullativ e procedural, si dhe praktikat mbikëqyrëse janë në një nivel të lartë ekuivalente dhe të përafuara me standardet e Bashkimit Europian.

Në përmbushje të rolit të saj ligjor si autoritet i ndërhyrjes së jashtëzakonshme në vend, Banka e Shqipërisë ka hartuar plane të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, si dhe ka përcaktuar instrumentet të cilat nevojiten për zbatimin e këtyre planeve për të gjitha bankat që operojnë në tregun vendas. Synimi është që bankat të kenë kapacitete të mjaftueshme financiare për të përthithur humbjet në rast të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, si dhe për të siguruar vijueshmërinë e funksioneve kritike, pa përdorimin e fondeve publike. Gjithashtu, janë kryer inspektime në bankat me rëndësi sistemike për të vlerësuar kapacitetet në rast të zbatimit e planeve për ndërhyrjen e jashtëzakonshme dhe janë lënë rekomandimet përkatëse.

Në rolin e mbikëqyrësit dhe reformatorit të sistemeve të pagesave, Banka e Shqipërisë siguroi funksionimin normal të sistemeve të pagesave. Dy projekte të rëndësishme për shërbimet e pagesave tërheqin vëmendjen gjatë leximit të raportit: ai për debitimin direkt ndërbankar dhe ai për kryerjen e pagesave ndërbankare në euro brenda vendit për klientët e bankave, duke shmangur bankat korrespondente. Funksionimi i këtyre sistemeve sjellë avantazhe të mëdha për

konsumatorin nëpërmjet krijimit të fleksibilitetit, uljes së ndjeshme të kostove dhe rritjes së aksesit në shërbimet e pagesave. Gjithashtu, ai mundëson integrimin e sistemeve të pagesave në tregun evropian të pagesave.

Po ashtu, statistikat tregojnë se viti 2021 shënoi rritje të ndjeshme të përdorimit të instrumenteve elektronikë të pagesave, zhvillim i nxitur nga masat e Bankës së Shqipërisë dhe politikat e bankave për promovimin e tyre. Duket se objektivat e strategjisë kombëtare 2021-2023 për pagesat me vlerë të vogël për rritjen e aksesit në shërbimet e pagesave janë arritur tashmë.

Në përmbushje të funksionit të saj si emetuese e parasë shqiptare, Banka e Shqipërisë akomodoi kërkesën për cash në ekonomi. Këtë vit ajo hodhi në qarkullim serinë e re të prerjes 1000 lekë, si dhe prerjen e re me vlerën më të lartë 10000 lekë, proces i cili u shoqërua dhe me një fushatë edukuese mbi kartëmonedhat shqiptare, e cila është pjesë e edukimit bankar që institucioni juaj bën në mënyrë të vazhdueshme.

Banka e Shqipërisë ka administruar me kujdes edhe rezervën valutore të vendit. Ajo ka punuar për përmirësimin e bazës rregullatore dhe infrastrukturës, me qëllim zgjerimin e klasave të instrumenteve, ku mund të investohet rezerva. Niveli i rezervës valutore konsiderohet i përshtatshëm dhe në mbështetje të stabilitetit monetar dhe financiar të vendit.

Një kontribut të rëndësishëm Banka e Shqipërisë ka vijuar të japë në procesin e integritit evropian të vendit. Ajo ka përmbushur detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, raportprogreset e Komisionit Europian, nënkomitetet e përbashkëta BE-Shqipëri, si dhe Plani Kombëtar për Integrimin Europian.

Në raport me përfaqësimet në institucione ndërkombëtare financiare, Banka e Shqipërisë ka përmbushur detyrimet financiare që rrjedhin nga anëtarësimi në FMN dhe Bankën Botërore, detyrimet raportuese dhe detyrimet në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit.

Banka ka një traditë të gjatë komunikimi të hapur me Kuvendin, institucionet dhe publikun shqiptar, në qendër të të cilës qëndron llogaridhënia dhe transparenca. Nëpërmjet përdorimit të një shumëllojshmërie kanalesh komunikimi, si: raporte, studime, fjalime, njoftime, intervista, publikime, të cilat janë pjesë e komunikimit masiv me publikun, Banka e Shqipërisë shpjegon vendimmarrjet e saj dhe, njëkohësisht, rrit njohuritë financiare të publikut.

Bazuar në sa më sipër, mendoj se aktiviteti i Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2021 ka qenë i suksesshëm në përmbushjen e detyrave të saj ligjore. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë ka

plotësuar dhe detyrat e rekomandimet e lëna nga Kuvendi i Shqipërisë, duke iu referuar rezolutës së vitit 2021, ku janë përmbushur rekomandimet e lëna dhe gjithashtu ka vijuar të kontribuojë pozitivisht në procesin e dialogut për sfidat e zhvillimit që ka vendi dhe marrjen e masave për zgjidhjen e këtyre sfidave.

Në mbyllje, dëshiroj të bëj një koment të shkurtër lidhur me atë që percepton publiku për Bankën e Shqipërisë. Ne kemi pasur jo më larg se dje të njëjtin raport vjetor të AMF-së dhe, për hir të së vërtetës, duhet thënë që shërbimet financiare, si ato bankare dhe jobankare, nuk janë të thjeshta për t'u perceptuar nga publiku. Nëse në terminologji perceptimi është i vështirë nga ana e publikut, unë mendoj se nuk është kaq i vështirë sa i përket perceptimit në lidhje me besueshmërinë që publiku ka për bankat dhe, në rastin konkret për institucionin tuaj. Publiku ose beson të institucionet financiare, ose nuk beson, ose besoj te sistemi bankar, ose jo. Në fakt, ka tregues që në raport, po t'i lexosh në detaje, dalin qartësisht. Publiku i beson Bankës së Shqipërisë dhe besoj se kjo ka qenë arsyeja kryesore e rimandatimit tuaj për të drejtuar Bankën e Shqipërisë në një mandat të dytë dhe, së bashku me Këshillin Mbikëqyrës, ku dy vendet vakantet i plotësuam së fundi, unë mendoj se ju duhet të jeni garancia për t'i dhënë publikut atë që është thelbi i punës së gjithë institucionit tuaj, i cili duhet të ofrojë sigurinë e një sistemi bankar, likuid, të qëndrueshëm dhe të besueshëm.

Unë ju uroj suksese në vijimësi dhe përmirësim të punës suaj.

Faleminderit!

Eduard Shalsi - Faleminderit, zonja Resulaj!

Fjala për zonjën Tabaku.

Jorida Tabaku- Faleminderit, zoti kryetar!

Duke falënderuar Guvernatorin dhe stafin që e shoqëron, së pari, më lejoni të shpreh shqetësimin tim për faktin që me ripërtëritjen e mandatave në Bankën e Shqipërisë nuk u bë e mundur të krijohet një balancë me anëtarët e bordit të Bankës së Shqipërisë, duke pasur edhe një përfaqësi të opozitës. Sigurisht që ky është një shqetësim që lidhet me qeverinë dhe jo me punën bankës.

Duke e falënderuar, njëkohësisht, edhe për informacionin e dërguar këtij komisioni, unë dua të ndalem në disa shqetësime që besoj se janë të kundërta me ato të relatores tjetër, por që po përpiqem t'i evitoj komentet përgëzuese, duke qenë se u bënë mjaftueshëm në këtë komision dhe po ngre disa shqetësime edhe nga ana e opozitës.

Situata ekonomike dhe politike që po kalon i gjithë globi, që në fakt duhet ta njohim, por, sidomos Shqipëria, nuk është më e mira e mundshme. Shëndeti i financave publike, në rastin e Shqipërisë, dhe buxheti i shteti ka qenë në këtë situatë edhe para dy fenomeneve, të paktën, globale, që kanë prekur, si i pandemisë, ashtu edhe ndikimi i luftës në Ukrainë. Nuk janë të rralla rastet kur institucionet ndërkombëtare të financave, si Banka Botërore apo FMN-ja, kanë kritikuar qeverinë në lidhje me treguesit makro, por njëkohësisht edhe me cenimin e disa parametrave , të cilët vendosin në pikëpyetje ecurinë afatmesme dhe afatgjatë.

Kritikimi i qeverisë sa i përket borxhit publik dhe shpenzimeve janë dy fusha kryesore, të cilat unë dua t'i përmend. Filozofia e ndjekur nga qeveria shqiptare ka qenë aq problematike saqë, ndonëse jemi vendi me borxhin më të lartë publik në rajon, kishim ndihmën me të vogël në rajon lidhur me COVID-19. Situata postCOVID, sikundër edhe shifrat tregojnë, ka prodhuar një ngërç në rritjen ekonomike. Vetë Banka e Shqipërisë ia atribuon rritjen ekonomike dhe, njëkohësisht, faktorët që lidhen me rritjen ekonomike, jo mbështetjes që ka dhënë qeveria, por disa politikave të marra në rastin e rindërtimit, të cilat kanë ndikuar dhe kanë pasur një kontribut domethënës në treguesit e rritjes ekonomike. Kjo situatë ka prodhuar më pak të ardhura për konsumatorët dhe sipërmarrjet, nga ana tjetër, ka pasur presione inflacioniste, që kanë filluar të ndihen në ekonominë shqiptar, pavarësisht agresionit rus në Ukrainë dhe është dokumentuar nga të dhënat e INSTAT-it që në fillimet e verës së vitit të shkuar, si pasojë e zinxhirit të furnizimit është nxitur një rritje çmimesh në disa sektorë të veçantë dhe në disa produkte të veçanta. Në këto kushte, qeveria shqiptare, në vend që të merrte masa për të parandaluar këtë situatë në lidhje me faktorë të brendshëm, vazhdoi të merrte kredi edhe në formën Eurobondit.

Problemet aktuale sa u përket rritjes së çmimeve, kanë sjellë një presion inflacionist, i cili llogaritet në 6,3% në muajin prill të vitit 2022. Gjykimet janë, duke u bazuar edhe në shqetësimet që unë kam ngritur herë pas here për të dhënat e INSTATI-it, që ky presion është më i lartë. Megjithëse kemi presione të tilla inflacioniste, Banka e Shqipërisë është treguar korrekte në masat e marra, ndonëse këto presione duhet të ishin shoqëror nga ana e qeverisë me masa dhe për pagat më të ulëta, por, njëkohësisht, edhe me masa për ndikimin e varfërisë në përgjithësi, por edhe për të gjithë qytetarët. Sipas llogaritjeve rezulton se norma e inflacionit vetëm te familjet e varfra dhe me të ardhura më të ulëta ka pasur një rritje më të lartë, pothuajse 1%, të drejtpërdrejtë, pa llogaritur atë të tërthortë, duke ndikuar edhe në zvogëlimin e të ardhurave të disponueshme.

Treguesit e ndryshëm, të cilët janë publikuar ditët e fundit, siç është treguesi për besimin në ekonomi të familjet, ku ka pasur një rritje me 17% të familjeve që gjykojnë se perspektiva është në rënie, sigurisht që duhet të ishin një tregues për qeverinë, në mënyrë që të marrë masat e përshtatshme.

Përpos kësaj, situata problematike në lidhje me të dhënat që vijnë nga borxhit publik flasin për një rritje të borxhit publik, sipas shifrave të Ministrisë së Financave, në nivelet e 70%. Në qoftë se llogaritim të dhënat nga partneritetet publike private, borxhi i fshehur, të dhëna, të cilat lidhen me detyrimet e qeverisë shqiptare në arbitrazh, atëherë, borxhi publik real e kalon shifrën e 100% të PPB-së. Me këtë lidhet edhe pyetja ime e parë. Si e gjykon Banka e Shqipërisë menaxhimin buxhetor gjatë vitit 2021 dhe 2022, megjithëse raporti është për vitin 2021? A e vlerësoni se qeveria shqiptare duhet të marrë masa për të ndaluar pagesa joprioritare, ashtu siç thotë FMN-ja, dhe faktit që borxhi po shkon drejt shifrave treshifrore? Situata rëndohet edhe më shumë në qoftë se kemi parasysh se normat e interesit do të rriten dhe, për rrjedhojë, do të kemi edhe normë interesi mbi principalin, duke pasur parasysh tendencën e qeverisë për Eurobondet, këtu u referohem dy të fundeve, veçanërisht atyre për sektorin e energjisë, të cilët janë marrë nga qeveria në situata emergjence, duke treguar njëkohësisht paaftësinë e qeverisë për të parashikuar.

Me gjithë paralajmërimet e vazhdueshme të FMN-së në lidhje me shpenzimet e qeverisë dhe borxhin e marrë prej saj, qeveria ka vazhduar ta trajtojë këtë temë jo me pikëpamjen e duhur financiar, duke pasur parasysh konservatorizmin e duhur financiar në këtë rast, por duke pasur parasysh kalimin e emergjencës dhe jo fokusimin në prioritetet që duhet të kishte për të mbështetur shtresat në nevojë.

Fatkeqësisht, zoti Guvernator, unë konstatoj që edhe Banka e Shqipërisë nuk ka qenë e përfshirë siç duhet në vlerësimin e borxhit.

Mbështetja e opozitës e dhënë për Guvernatorin sigurisht që duhej të merrej si një sinjal për të qenë jo përfaqësues i opozitës, as përfaqësues i qeverisë, por për të qenë mbi palët, për të qenë një oponencë në situata të vështirësive ekonomike. Unë besoj që Banka e Shqipërisë duhet të fliste më fort për borxhin, për shpenzimet joprioritare, për partneritetet publike private, të cilat, për mua, janë jashtëzakonisht shqetësuese.

E njëjta situatë është vërejtur edhe gjatë pandemisë dhe ndihma ekonomike e qeverisë shqiptare, ku fondi për COVID-19, bazuar njëkohësisht edhe te garancia sovrane u kalua pothuajse, vetëm në një grup kompanish dhe në gjykimin tim kjo duhet të ishte shpërndarë në

ekonomi, në mënyrë që efektet e pandemisë dhe mbështetja që jepte qeveria të ndiheshin njësoj në të gjitha shtresat e ndryshme shoqërore.

Për mua ka qenë shqetësues edhe qëndrimi që Banka e Shqipërisë ka mbajtur gjatë periudhës së parë të goditjes së inflacionit në vendin tonë. Në një kohë kur ekonomia e vendit po vuante ngërçin e parë të krijuar nga COVID - 19 situata në vend po përkeqësohej, Banka e Shqipërisë në gjykimin tim duhet të kishte luajtur një rol më të rëndësishëm dhe më jetik, si institucioni i vetëm i veçantë me rëndësi ekonomike, por njëkohësisht si i vetmi institucion i pavarur, krahas Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili duhet të monitorojë politikat dhe vendimmarrjen qeverisë për të krijuar njëkohësisht edhe një balancë.

Përpos ndikimeve inflacioniste, vazhdojmë të shohim një fenomen tjetër problematik, që ka filluar pak më herët se një vit më parë, ai i transferimit të kapitalit. Në Shqipëri po i afrohem numrit më pak se 3 milionë banorë dhe konkurrenca po bëhet gjithmonë e më e vështirë në tregun e sektorit bankar, në bankat e nivelit të dytë, kështu që unë besoj se ka shumë banka të nivelit të dytë, të cilat e kanë transferuar kapitalin e tyre. Gjithashtu, kemi banka që kanë pronësi kapitali nga vendet e Bashkimit Europian, banka që kanë pronësi nga kapitali vendas, por shqetësim tregojnë bankat me kapital të huaj lindor. Ky është një shqetësim që unë e kam ngritur me ju, edhe në rastin e fundit, kur keni raportuar në këtë komision.

Është një shqetësim i vazhdueshëm kontrolli mbi këto banka, por njëkohësisht edhe monitorimi i shtuar që Banka e Shqipërisë duhet të ketë ndaj kapitalit. Sigurisht, Banka e Shqipërisë dhe autoritete të tjera të pavarura financiare duhet të ushtrojnë rolin e tyre në monitorimin e këtij sektori bankar në bashkëpunim edhe me Autoritetin e Konkurrencës. Banka e Shqipërisë, të paktën në një rast të transferimit të kapitalit, ka kërkuar edhe mendimin e Autoritetit të Konkurrencës, për sa u përket çështjeve të transferimit të kapitalit. Ndërkohë që flasim për një situatë të pazakontë ekonomike, shifrat flasin për një stagflacion shumë herë më të mundshëm se disa muaj më parë.

Unë besoj se kjo duhet parë edhe nga qeveria e Shqipërisë. Ministrja e Financave më ka dhënë disa herë leksione ekonomie, sa herë ka pasur rastin në Kuvend, por sot në të gjithë botën po flitet gjithnjë e më shumë për stagflacion, i cili vjen si rezultat i prirjeve të rritura inflacioniste nga njëra anë, por nga ana tjetër, kjo situatë nuk është shoqëruar me një rritje ekonomike, ashtu siç po shihet nga të gjitha institucionet ndërkombëtare që është rishikuar në

rënie. Unë besoj që Banka e Shqipërisë duhet patjetër ta shikojë këtë situatë me prioritet dhe njëkohësisht të japë kontributin e saj aq sa i takon.

Unë gjykoj se Banka e Shqipërisë ka një proces digjitalizimi, i cili është për t'u përgëzuar, por dua të ngre shqetësimin që ky proces duhet bërë njëkohësisht krahas masave të veçanta për shtresat në nevojë, pra, në lidhje me masat për krijimin e depozitave të posaçme për pensionistët, për ata që marrin ndihmën ekonomike, për ata që marrin pagesën e papunësisë, të cilët ndoshta nuk kanë akses dhe nuk kanë të njëjtën normë dixhitalizimi, siç mund të kenë të gjitha shtresat e tjera të ekonomisë, ata nuk duhet ta kenë të vetmen mënyrë pagese. Unë mendoj se jemi jashtë realitetit, nëse flasim për një fazë dixhitalizimi të këto shtresa, të cilat preken në mënyrë të veçantë në momentin, kur ka vështirësi të jashtëzakonshme aksesit, sidomos në zonat rurale. Dua që patjetër ky komision, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, të sigurohet se kjo strategji që ka ndërmarrë Banka e Shqipërisë për rritjen e aksesit financiar të bëhet në momentin kur të gjitha këto shtresa, që unë përmenda, të jenë të mbuluara me shërbim, përpara se ne të kalojmë në të vetmen mënyrë pagese.

Konsumi ka pësuar vetëm një rritje të lehtë, ndërkohë që treguesit kryesorë të ekonomisë janë në rënie, duke lexuar edhe raporte alternative përveç atyre që paraqet INSTAT-i. Kështu që, në kushte të tilla, unë gjykoj se Banka e Shqipërisë nuk duhet të ngulë këmbë në këtë proces, të paktën për këto shtresa të shoqërisë që unë përmenda. Ne duhet të kuptojmë se qëllimi kryesor i Bankës së Shqipërisë është të jetë e shkëputur totalisht nga politizimi i tejskajshëm, qoftë kjo opozitë apo maxhorancë.

Unë gjykoj se situata ekonomike në fushën e bujqësisë është jashtëzakonisht problematike. Në këtë komision është ngritur herë pas here shqetësimi që bujqësia është prekur nga politikat e reja fiskale. Bujqësia është një sektor që ka një potencial shumë të lartë, por një rritje shumë të ulët, herë-herë edhe negative, kështu që gjykoj që Banka e Shqipërisë duhet t'i japë një qasje edhe këtij fenomeni, duke parasysh edhe aksesin e këtij sektori në financa.

Një tjetër e dhënë interesante është edhe ajo që lidhet me forcimin e lekut karshi euros, ndërkohë që Banka e Shqipërisë vazhdon të insistojë duke pasur një rritje të politikave deurozuese. Faktet flasin se një politikë e tillë nuk është efektive dhe nuk e ka arritur, fatkeqësisht, efektin që donim të kishim. Kjo tregohet njëkohësisht edhe me tendencën e normave të këmbimit që, fatkeqësisht, po ndikohen edhe nga faktorë të jashtëm.

Pikëpyetjet që ngrihen në këtë prizëm janë shqetësime që ngrihen edhe me prokurimet publike, PPP-të, të cilat kanë një lidhje të drejtpërdrejtë në menaxhimin e borxhit, por njëkohësisht edhe në tregues të tjerë makroekonomikë të vendit. Unë gjykoj se duhet të kemi më shumë qartësi, po njëkohësisht edhe më shumë presion nga ana e qeverisë, për të zbatuar politika kontabiliteti, të cilat nuk lidhen vetëm me punën e Bankës së Shqipërisë, por që vendosin transparencë në lidhje me vlerën reale të borxhit.

Pak kohë më parë, ne kemi pasur në këtë komision Kontrollin e Lartë të Shtetit, që na raportoi se rreziqet kryesore të borxhit lidheshin me 3 fusha kryesore. Rreziku i parë ishin partneritetet publike private që kanë dalë jashtë kontrolli, i dyti ishte borxhi i larët publik dhe rreziku i tretë ishin gjyqet në arbitrazh, të cilat në gjykimin tonë janë duke ushtruar një presion mbi financat publike. Prandaj është jetike për institucione si Banka e Shqipërisë që të vendosë në shina sjelljen e qeverisë, kur ajo trajton tregues të borxhit publik.

Moratoriumet e kredive dhe lehtësimi i përkohshëm i rregullave të klasifikimit dhe provigjionimit të kredive, kanë përfunduar pa efekte negative në flukset dhe performancën e kredisë bankare deri më tani. Megjithatë, rreth 30% e totalit të kredive janë ristrukturuar nga marsi në dhjetor të vitit 2020, ku 7% e kredive të ristrukturuara nuk funksiononin para pandemisë. Duke qenë se ndikimi i plotë i goditjeve në bilancet e bankave mund të bëhet i dukshëm vetëm pas një farë kohe dhe jo këto 2 vjet, në momentin kur të kenë kaluar efektet, unë gjykoj që monitorimi i ngushtë i cilësisë së portofolit të kredisë dhe identifikimi i menaxhimit në kohë të aktiveve problematike, duhet të jetë thelbësor dhe banka duhet të ushtrojë një mbikëqyrje të zgjeruar në vend edhe jashtë saj. Aty ku shfaqen mungesa kapitali duhet të miratohet një plan i besueshëm për restaurimin e kapitalit, ndërkohë që mund të lejohet rënia e kapitalit përkohësisht duke parasysh parametrat dhe kufijtë e kujdesit.

Unë gjykoj se duhet një mbikëqyrje e shtuar e tregut për rritjen e shpejtë të pasurive të paluajtshme. Kreditë hipotekore zënë pothuajse 64% për individët, por njëkohësisht kredia e ndërtimit zë 13% të totalit të kredisë për ndërmarrjet. Unë besoj se është në interes për këtë komision, jo vetëm sot, por edhe në të ardhmen, që të monitorojmë financimin e sektorit të ndërtimit. Disa vjet më parë në këtë komision kemi pasur një debat shumë të ashpër me zotin Braçe për sa i përket financimit të sektorit të ndërtimit.

Si deputete ju kam nisur një shkesë për të ditur se me çfarë të ardhurash financohet sektori i ndërtimit, me burime alternative apo me burime të vetë sektorit bankar, cilat janë

burimet kryesore dhe çfarë po bën Banka e Shqipërisë për të monitoruar masën e financimit të sektorit të ndërtimit duke pasur parasysh edhe burimet e paligjshme në sektorin e ndërtimit.

Në prill të vitit 2021 është publikuar raporti i dytë, vlerësimi i MONEYVAL-it i vitit 2018, ku përgjithësisht konstatohet se Shqipëria ka pasur një përmirësim për sa i përket pastrimit të parave, financimit të terrorizmit në përputhje me rekomandimet e FATF-së.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon.)

Hall të vish në komision, hall të mos vish. Tani, kam disa shqetësime, që do t'i ngre.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon.)

Jo nuk e kisha për ju. E kisha në përgjithësi për disa prej kolegëve.

Vetëm disa hapa pozitivë u ndërmorën nga autoritet shqiptare, kryesisht ishin ato ligjore.

Raporti pasues përfshinte, gjithashtu, zbatimin e kërkesave të reja ndërkombëtare. Një shqetësim që është ngritur herë pa here lidhet me legjislacioni dytësor, për sa u përket kriptomonedhave. Ndoqa online një pjesë të diskutimit të bërë dje me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, besoj se i takon edhe Bankës së Shqipërisë një pjesë e diskutimit në lidhje me këtë fenomen.

Dua t'ju pyes për sa i përket amnistisë fiskale dhe penale që qeveria shqiptare parashikon të ndërmarrë. Në gjykimin tuaj sa mund të ndikojë kjo? Si vlerësohet nga Banka e Shqipërisë shëndeti i sektorit financiar në përgjithësi? A ka realizuar Banka e Shqipërisë stres teste në lidhje me bankat e nivelit të dytë?

Kam ndjekur me shqetësim ankesat dhe kërkesat e disa konsumatorëve për sa u përket kostove të shërbimeve të ofruara nga bankat e nivelit të dytë, për sa i përket mirëmbajtjes së llogarive, kostot e transaksionit, të cilat janë ngritur si shqetësim. Çfarë bën Banka e Shqipërisë në lidhje me kërkesa dhe cilat janë disa nga masat që mund të merren, sigurisht brenda rolit dhe autoritet që i takon Bankës së Shqipërisë?

Këto ishin disa nga shqetësimet kryesore që unë doja të përmendja, duke përfunduar me vlerësimin që mund të ketë Banka e Shqipërisë për dy kreditë sovrane të dhëna vitet e fundit: si janë implementuar ato? Cili ka qenë efekti në ekonomi dhe a keni ndonjë raport të veçantë për to? Pra, për dy garancitë e dhëna nga ana e qeverisë për kredi në banka të nivelit të dytë.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zonja Tabaku!

Atëherë, kam disa kërkesa.

Së pari, fillojmë me pyetjet, ku e para është zonja Denaj, pastaj zonja Koliqi, zonja Dhima, zoti Xhelili, zoti Braçe.

Së dyti, kërkohet ndjesë, për shkak se tani do të zhvillohet Konferenca e Kryetarëve e thirrur para disa kohësh, dhe mua më duhet të shkoj atje, kështu që drejtimin e komisionit do ta marrë zonja Gjylameti. Unë do të rikthehem sapo të mbaroj.

Rendi i mbledhjes është ky që sapo ju thashë.

Anila Denaj – Faleminderit, kryetar!

Në fakt, jo për të bërë shumë falënderime, por për të konstatuar që bashkëpunimi midis institucioneve shumë të rëndësishme siç është Ministria e Financave, Banka Qendrore dhe institucione të tjera, në një moment të vështirë krize është ajo për të cilën dua t'ju vlerësoj jo vetëm për vitin 2021 që e kemi në diskutim, por edhe për vitet më parë.

Duke marrë një fjali të zonjës Tabaku, ku foli për oponencë dhe ndarje, dua të them: jo, oponenca dhe ndarja është në mendjen tuaj, por në situatën e ruajtës së ekuilibrit makroekonomik-financiar komunikimi, bashkërendimi i aksioneve brenda institucioneve ligjzbatuese është kyç. Unë dua të them që kjo ka qenë një nga arsyet pse ne kemi kaluar një nga sprovat më të vështira në dy vjetët e fundit dhe jam e bindur që do e kalojmë edhe këtë vështirësi të kësaj krize të tretë, për të arritur jo ato rezultate të cilat u përmendën pak më parë (unë dua të flas shumë konkretisht me 3 shifra, jo me shumë fjalë, sepse edhe njerëzit lodhen), por për të arritur një rritje ekonomike 4,76% në krahasim me vitin 2019 dhe si rezultat i një tkurrjeje nga më të voglat në rajon dhe rritjes shumë të lartë të vitit të kaluar me 8,5% e cila materializohet në 4,76%, një ulje të papunësisë në tremujorin e fundit të vitit të kaluar me 11,4% nga 12,3% që ishte në vitin 2018, si dhe një ulje të borxhit nga 66,3% që ishte në vitin 2019, shkoi në 74,5% dhe në vitin 2021 shkoi në 73,2%, për të realizuar brenda një viti të vështirë, siç ishte vitin 2021, një konsolidim fiskal. Këto janë 3 shifra për të cilat, të gjithë, edhe ne në këtë komision, që e kemi detyrim profesional, duhet të flasim me shifra dhe jo me fjalë, përtej të gjitha foltoreve të tjera. Këto janë 3 shifra që tregojnë punën e të gjithë institucioneve ligjzbatuese, duke përfshirë dhe punën e Bankës së Shqipërisë dhe për këtë bashkëpunim ju falënderoj!

Për të kaluar te pyetjet, unë i kam ndarë në dy grupe dhe dua të filloj nga pjesa që lidhet me deuroizimin. Duke marrë shkas nga ajo që edhe ju thatë pak më parë, është bërë një punë prej vitësh tashmë, mund të jenë 5 deri në 6 vjet të paktën, ku përpjekja për të rritur dhe për të ekuilibruar portofolin në valuta, si dhe për të ulur riskun e kursit të këmbimit ka qenë me

rezultate konkrete. Megjithatë, ju thatë pak më parë në fjalën tuaj që nuk janë kërkuar ndërhyrje vitin e shkuar, për të vijuar procesin e deurozimit edhe pse e shikoni që është në një nivel të lartë risku i sjellë si rezultat i monedhave të ndryshme. Nuk e kuptoj pse. Kjo ndoshta lidhet me vitin ose e kam keqkuptuar unë. Pyetja ime është: çfarë keni në planin e punës së këtij viti për të kompensuar këtë vit, qoftë me ndërhyrjet e vitit 2021, qoftë me masa drejt deurozimit dhe uljes së keshit në ekonomi? Kjo, duke marrë parasysh edhe sektorin e rëndësishëm të ndërtimit që u përmend pak më parë, por jo vetëm në kuadër të informalitetit, të pastrimit të parave, siç e tha zonja Tabaku, por mbi të gjitha edhe të kesh-it në ekonomi, edhe të monedhës, sepse ne e dimë shumë mirë që shumica e kontratave në sektorin e ndërtimit lidhen me euron. A ka ardhur koha që të fillojmë të flasim së bashku edhe me institucionet e tjera për të vendosur disa limite, ku të jetë monedha vendase ajo që përcakton ndarjen dhe vendimmarrjen në këto kontrata, për të qenë një instrument jo vetëm për të ndikuar masa më shumë drejt politikë së deurozimit, por edhe për të vendosur kufij sesi këto transaksione ndodhin totalisht në ndihmë të procesit të uljes së keshit në ekonomi?

Ndërkohë, grupi i dytë i pyetjeve lidhet me portofolin e kredisë. Ne kemi vuajtur ndër vite një përqindje shumë të ulët të portofolit të kredisë në sektorin e bujqësisë, nëse unë nuk gaboj, flasim që sektori i bujqësisë e ka në total portofolin 2%. Nuk po marr si referencë vitin 2021, por po flas për 3 - 4 vjetët e fundit, edhe kur politikat fiskale kanë qenë lehtësuese, zonja Tabaku. Ka diçka që lidhet me aksesin në financë në këtë sektor, apo ka diçka që lidhet me informalitetin në këtë sektor? Si do të jetë perspektiva e aksesit në financë për sektorin e bujqësisë që kontribuon me 20% të produktit të brendshëm bruto? Pyetja konkrete është: si ka ardhur ecuria e portofolit të bujqësisë nga njëri vit në tjetrin dhe kryesisht në vitin 2021? Kam interes ta di edhe për sektorin e turizmit, sepse të dy janë sektorë shumë të rëndësishëm, edhe pse zhvillimi ekonomik nuk mund të mendohet pa rritjen e portofolit të kredisë. Sa është rritja e portofolit të kredisë për individët? Këtu dua të di për atë pjesë portofoli që nuk kontribuohet nga sistemi bankar, por nga sistemi jobankar.

(Deputeti Edmond Spaho ndërhyr nga salla pa mikrofon.)

Zoti Spaho, ne mund ta bëjmë bisedën e taksave, por nuk po i referohem politikës fiskale, po i referohem...

(Deputeti Edmond Spaho ndërhyr nga salla pa mikrofon.)

Por ju bëtë gjithë ato pyetje për bankën, kur s'ishin relevante, tani unë po bëj pyetje për bankën dhe ju ndërhyini. Unë nuk ju kam ndërhyrë.

E thashë edhe pak më parë, mora referencë 2%-shin e sektorit, kur politikat fiskale ishin lehtësuese, kjo nuk do të thotë që ne nuk mund të bëjmë debat për politikat fiskale, por të themi çka përtej asaj politik fiskale. Dhe fola për bujqësinë, për turizmin dhe individët. Tek individët dua të di pak më në detaje, për atë pjesë të portofolit të kredisë së individëve që nuk vjen nga sektori bankar. Këtu dua të theksoj nevojën për të parë nëse kjo është një përqindje e rritur, a shikohet një risk potencial? Pra, ky risk duhet gërshetuar jo vetëm me atë që ju thatë pak më parë, me çështjen e informacionit që lidhet kryesisht me klientët e institucioneve jobankare, por unë dua të them që duhen bërë përpjekje për të ndikuar në ngushtimin e këtij fenomeni, jo vetëm me edukim, por edhe me masa disiplinore.

Mendoj se i kemi të vonuar këto masa, të paktën në raport me portofolin e kredive të individëve, pasi jo vetëm norma e interesit është e lartë, por ato jepen pa kriter. Portofoli i kredive për individë në institucionet jobankare, në gjykimin tim, duhet të jetë në vëmendje me supervizim, por kjo ngelet në diskrecionin tuaj. Unë thjesht dua të di sesi është tendenca e rritjes së portofolit dhe e rritjes së kredive në këtë portofol.

Disa pyetje të tjera që lidhen po me këtë çështje. Sa është përqindja e rifinancimit? Sa është përqindja e ristrukturimit të kredive në vitin 2021? Sa është rritja reale e kredisë së re? A ndikon në rritjen e portofolit pjesa e informalitetit, që e kemi folur edhe këtu në komision, e të qasurit të dy balancave? Është një rregull shumë i mirë i Bankës Qendrore i vendosur në vitin 2018 për kreditimin vetëm me pasqyra fiskale, i shpallur më herët, që në vitin 2016, megjithatë ne nuk e kemi kaluar pragun ku pasqyrat fiskale dhe ato reale të jenë një dhe për këtë arsye shumë biznese kanë vështirës: a ndikohet aksesit në financa edhe prej kësaj gjëje? A duhet të ishte më e lartë rritja ekonomike sikur këto të kishin realizuar një ngushtim të këtij *gap*-i? Në këtë kuadër, bizneseve me të ardhura të ndershme, amnistia do t'u bënte shumë punë, zonja Tabaku.

(Deputetja Jorida Tabaku ndërhyi nga salla pa mikrofon.)

Jo, nuk ju bëra pyetje, iu referova fjalive tuaja, të cilat jo gjithmonë konstatojnë atë që është realitet.

(Deputetja Jorida Tabaku ndërhyi nga salla pa mikrofon.)

Po sigurisht, sepse, ju më shumë se katër herë thatë të pavërteta.

Këto pyetje kisha!

Ju falënderoj!

Blerina Gjylameti - Atëherë, vijojmë me zonjën Koliqi për pyetje.

Ju lutem, pyetjet të jenë sa më konkrete, që të ftuarit të arrijnë t'i mbajnë shënim, sepse duke bërë parashtesa të gjata, besoj se kanë probleme dhe në të mbajturit mend të thelbit të pyetjes, ose përsëritini në fund.

Emilja Koliqin – Faleminderit!

Faleminderit, zoti Guvernator!

Vitet e fundit vihet re një ulje e numrit të bankave të nivelit të dytë dhe me mbylljen e procesit të shitjes së Alpha Bank dhe me dhënien e dakordësisë nga Autoriteti i Konkurrencës për këtë shitje, numri i bankave të nivelit të dytë shkon në 11. Pra, ka një përqendrim të tregut bankar edhe në duart e aksionerëve shqiptarë. Meqenëse ju jeni autoriteti përgjegjës për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e bankave, a keni një prognozë për sigurinë e bankave të nivelit të dytë, bazuar edhe në monitorimin e riskut, dhe sa e sensibilizoni opinionin publik për këto probleme?

Në muajin mars Banka Botërore ka bërë një parashikim për rritjen ekonomike të Shqipërisë me 3,3%, kurse tani e ka ulur në 3%. Sa e parashikon Banka e Shqipërisë rritjen ekonomike për këtë vit dhe për vitet në vijim, meqenëse në një dalje tuajën publike ju keni bërë një parashikim? Pra, a keni një rivlerësim të kësaj rritjeje ekonomike?

Në lidhje me numrin e punonjësve që ka Banka e Shqipërisë, nga viti 2017-2021 ju e keni rritur atë nga 496 në 609 punonjës, pra, numri i punonjësve është rritur me 113, kurse fondi i pagave është rritur me 211 milionë lekë. A justifikohet rritja e numrit të punonjësve në Bankën e Shqipërisë, në një kohë që paga mesatare për një punonjës atje është afërsisht 173 mijë lekë, kurse paga mesatare në nivel vendi në tremujorin e katërt është rreth 59 mijë lekë, duke marrë për bazë edhe pagat maksimale, siç janë ato të ligjvënësve apo nëpunësve të lartë, që janë rreth 102 mijë lekë ose të aktiviteteve financiare dhe të sigurimit të aktivitetit privat që shkojnë 122 mijë lekë? Pra, a justifikohet kjo rritje e numrit të punonjësve dhe e pagës mesatare?

A keni ndonjë plan se çfarë do të bëhet me godinën ish-hotel “Dajtit”, meqenëse kjo godinë po degradohet përditë e më shumë dhe po kthehet në një gërmadhë?

Faleminderit!

Blerina Gjylameti - Faleminderit, zonja Koliqi!

Fjalën e ka zonja Dhima!

Antoneta Dhima - Faleminderit, zonja Gjylameti!

Faleminderit, zoti Guvernator!

Duke vlerësuar punën dhe angazhimin e Bankës së Shqipërisë në mbajtjen nën kontroll të tregjeve financiare, të normave të interesit dhe kostot e financimit, të cilat kanë qenë të ulëta, kurset e këmbimit, të cilat edhe ato kanë qenë të ulëta, si dhe fakteve që sektori bankar ka ruajtur tregues të mirë të përfitueshmërisë, të likuiditetit dhe të mjaftueshmërisë së kapitalit, kam disa pyetje.

E para, si pritet të jetë ecuria e kreditimit për vitin e ardhshëm, në kushtet që kemi një rritje të normës bazë të interesit dhe çfarë masash do të marrë Banka e Shqipërisë për të nxitur kreditimin?

E dyta, treguesi i NPL-së ose i kredive me probleme vazhdon të jetë me trend rënës. Cilat janë pritshmëritë e institucionit tuaj në lidhje me këtë tregues?

E treta, cili është opinionimi i Bankës së Shqipërisë në lidhje me inovacionin financiar?

E fundit, cili është opinionimi i Bankës së Shqipërisë në lidhje me krizën energjetike në Europë?

Faleminderit!

Blerina Gjylameti - Po, zoti Xhelili.

Alban Xhelili – Faleminderit, zonja drejtuese!

E para, unë dua të falenderoj Bankën e Shqipërisë dhe në veçanti Guvernatorin për punën e mirë dhe frymën pozitive që i ka dhënë të gjithë ekonomisë shqiptare dhe çdo shqiptari këtu, jo thjesht duke qenë optimist, por duke mbajtur një politikë makro stabël! Kjo ka qenë një frymë objektive dhe jo një frymë subjektive. Procesi i deeurozimit ka qenë shumë i rëndësishëm, gjë e cila ndikon dhe besoj se është një nga elementet kryesore edhe në forcimin të lekut dhe mendoj se duhet t'i kushtohet një rëndësi akoma edhe më e madhe, pavarësisht se gjithmonë do të ketë edhe elemente kundër dhe pro.

Gjithashtu, dua ta falenderoj edhe për punën e mirë në ruajtjen e normës së nivelit të inflacionit, sepse, pavarësisht se ku shikojmë dhe kë marrim ne për objektiv (mund të gjejmë vende, të cilat e kanë normën e inflacionit më të ulët sesa e jona), po të krahasohemi me vendet e Bashkimit Europian, sidomos në momentet e fundit të kësaj krize, besoj se jemi në nivele shumë të kënaqshme, edhe pse inflacioni si koncept nuk është ndonjë kënaqësi e madhe që ta kesh!

Unë kam disa pyetje.

Sa parashikohet të jetë përqindja e rritjes së inflacionit në vitin 2022? Po përqindja e rritjes së nivelit të pagave? Sa parashikohet të jetë rritja ose rënia reale e produktit të brendshëm bruto në vitin 2022, kur në vitin 2021 ka qenë 10,4%? Këtu u fol për nivel borxhi 100%, por unë doja të dija nga ju, zoti Guvernator, sa është niveli aktual i borxhit? Në krahun që jam, mua do të më vinte për shtat të thosha që niveli i borxhit është 10%, kurse krahu përballë mund të thoshte jo 10% por 1000%. Kështu që, unë dua të di sa është realisht niveli borxhi?

Koeficienti i qarkullimit të kartëmonedhës në vitin 2021 ka qenë 0,61 herë në vit. Kjo është një mesatare, sepse ka kartëmonedha, sidomos ato me prerje më të madhe, që qarkullojnë më shpesh. Çfarë duhet bërë me qëllim që ta rrisim pak nivelin e qarkullimit të parasë në sistemin bankar, sepse besoj që kjo do të ndikojë në mënyrë direkte edhe në nivelin e pagesave kesh, të cilat, patjetër, sjellin një situatë ekonomike që del jashtë kontrollit të gjithsecilit prej nesh?

Faleminderit!

Blerina Gjylameti – Po, zoti Braçe.

Erion Braçe – Zoti Guvernator, nisur nga fjala juaj, nga raporti, por edhe nga çfarë po ndodh, shikoj që kemi dy shqetësime: luftën dhe impaktin e saj, duke përfshirë sanksionet përkundrejt pushtuesit, Ruisë në këtë rast, si dhe inflacionin lidhur me këtë gjë. Nisur nga këto dy shqetësime, unë kam një grup pyetjesh.

E para, nga informacioni që ju keni, njihni sektorin, e keni nën kontroll, e mbikëqyrni, a është i infektuar sistemi ynë bankar? Mund të cenohet, mund të preket, do të ketë impakt mbi të nga sanksionet e vendosura mbi bankat ruse, mbi individë me shtetësi ruse, e natyrisht mbi persona të lidhur me ta, edhe mbi bankat, edhe mbi individët? Kjo lidhet me sistemin.

Pyetja e dytë lidhet me inflacionin. U bë kohë që jemi në një trend rritës dhe natyrisht ka 2-3 muaj që, edhe për shkak të fenomeneve të mëhershme, qoftë të rinisjes pas pandemisë, por edhe tani, për shkak të luftës, jemi edhe në mbi normë.

Kemi dy muaj e pak që operojmë me borde që caktojnë çmime për grupe mallrash, në sektorin energjetik, por edhe të ushqimeve të fabrikua. Çfarë ndikimi kanë pasur mbi normën e inflacionit këto borde?

E dyta, po përsëri për inflacionin, për shkak edhe të disa vendimeve të mëhershme të Autoritetit të Konkurrencës, është e qartë që në disa prej tregjeve të konsumit të ushqimeve,

atyre energjetike, por edhe në tregjeve të lëndëve të para, që ndikojnë drejtpërdrejtë mbi prodhimin, konkurrenca është tkurrur dhe tregjet janë të përqendruara. Çfarë ndikimi ka pasur konkurrenca e munguar mbi inflacionin?

E treta, po përsëri për këtë gjë, referuar edhe të dhënave të fundit të INSTAT-it për normën e inflacionit, të dala dje apo pardje, prej 6,2%, peshën më të madhe e ka zënë rritja e çmimeve të ushqimeve. Gjithkush merret me naftën, por në përqindje transporti zë një pjesë të vogël të shpenzimeve të qytetarëve, ndërkohë që tek ushqimet dhe veçanërisht me një goditje të fortë mbi grupet vulnerabël, por, pse jo, edhe shtresën e mesme, norma e inflacionit është rritur jashtë mase. Brenda grupit të ushqimeve çmimet e nënproduktit “vajra dhe yndyrna” vetëm në muajin prill kanë shkuar 24,2% plus, pasur nga nëngrupet qumësht, djathë dhe vezë me 17,1%; bukë dhe drithëra me 16,7%; reçel, mjaltë ëmbëlsira me 14,3%, mish me 7,8%, zarzavate, përfshirë patatet, me 5,2% plus.

Nisur nga kjo, do të doja të bëja dy pyetje.

E para, mos kemi ndonjë problem të rëndësishëm, të konsiderueshëm dhe që duhet marrë parasysh në strukturën e prodhimit, që ka edhe këtë impakt në rritjen e këtyre çmimeve, veçanërisht të dukshme tani?

E dyta, mos vallë politikat fiskale të tatimeve dhe taksave gjatë 2 vjetëve të fundit i kanë dhënë goditje sektorit prodhues, bujqësor dhe blegtoral, me pasojë rritjen e kostove dhe rritjen e çmimeve të prodhimeve në vend?

Pyetja tjetër lidhet drejtpërdrejt me diçka për të cilën ju pyeti zonja Denaj pak më herët, por unë dua ta zgjeroj.

Zonja Denaj pyeti për kredinë në total dhe kredinë e bujqësisë. Unë besoj se jemi të gjithë të interesuar, të paktën të dimë shifrat e fundit, cili është akses i sektorit të bujqësisë në kredimarrje në banka. Dua të di të njëjtin informacion edhe për në institucionet financiare jo banka. Pra, cila është kredia e bujqësisë në institucionet financiare jo banka? Të paktën, në sipërfaqe, nga aq sa kuptoj, por edhe nga kontakti me njerëzit që merren me prodhimin bujqësor, në qoftë se akses i në sistemin bankar për kredi të bujqve apo ndërmarrjeve bujqësore të krijuara, të vogla, është i papërfillshëm, në këtë pjesën tjetër është shumë i lartë.

Pyetja vijuese lidhet pikërisht me këtë pjesë të sektorit, me institucionet financiare jo banka dhe kredidhënien prej tyre. Ju keni shpallur (ky ishte viti i parë dhe kjo është një risi dhe gjë e mirë) normat efektive të interesit të këtij sektori. Për kredinë konsumatore deri në 200 000

lekë norma ishte 171%, për pjesën tjetër 200 000 lekë e sipër shkon deri në 39%. E lidhur me pyetjen e parë, do të doja të dija: Nuk ju duket negativ impakti i funksionimit të këtij sektori mbi bujqit dhe blegtorët?

Dakord, mund të mos jetë drejtpërdrejt pjesë e punës dhe aktivitetit të Bankës së Shqipërisë, por të shikosh propagandën e këtij sektori financiar jobankar, nuk përputhem me normat e interesit që ju keni shpallur publikisht. Po t'i dëgjosh apo të shikosh propagandën e paguar në të gjitha mediet, nuk filtron norma që ju keni shpallur publikisht dhe është në faqen e Bankës së Shqipërisë, pra, nuk filtron vendimmarrja juaj, transparenca që bën Banka e Shqipërisë në media.

Është çmenduri. Për shtatë minuta merrni kredi, thotë. Ka qenë pesë, por e kanë bërë shtatë. Kreditë e parë e ke falas, thotë. E kështu vazhdon.

Është një lloj propagande e neveritshme, por që nuk thotë të vërtetën. Do të ishte krejt normale nëse thotë për shtatë minuta merr kredi me 171% normë interesit dhe nuk zhyt, të paktën në dijeni time, qindra njerëz në këto histori e ku pjesa më e madhe janë bujq, të cilët kanë hyrë me kokë.

Pyetjet e tjera lidhen me çështjen e pastrimit të parave, që edhe ju e theksuat me forcë që e keni prioritet themelor.

Dje ishte këtu Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe natyrisht edhe me ta u bë i njëjti diskutim. Shqetësimi im është përtej legjislacionit që ne kemi miratuar, akteve nënligjore që kanë dalë dhe dje u raportua që janë plotësuar thujtë të gjitha në përmbushje të kërkesave të ligjit për kriptomonedhat, asetet virtuale.

Natyrisht, ka një propagandë sikur sistemi ka mbetur pas, sistemi bankar është një gjë e vjetër, e padobishme, që po kalohet, po tejkalohe nga asetet virtuale. Kohë pas kohe e dëgjojmë këtë pjesë dhe ka propagandë lidhur me këtë, që duhet të ndryshojmë për të ardhur te kjo gjë.

Në gjykimin e Bankës së Shqipërisë, si e shikoni këtë, si i shikoni lajmet, kryesisht të agjencive ligjzbatuese, për zbulimin e aktivitetit të paligjshëm, të pa-licencuar e, mbi të gjitha, kriminal në këtë aspekt?

Në gjykimin nga krahu tjetër, nga krahu i pastrimit të parave, ju rezulton që një pjesë e madhe e parasë që është jashtë kanaleve të qarkullimit legal, po përfundon këtu për t'u pastruar edhe paraja kriminale edhe paraja e korrupsionit?

A ka Banka e Shqipërisë një plan apo një strategji për t'u përballur me këtë fenomen, në bashkëpunim me të gjitha institucionet e tjera ligjzbatuese, se nuk mendoj që e bëni dot vetëm ju, përfshirë Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare apo prokurorinë e shtetit, Shërbimin Informativ, Policinë Kriminale e të gjitha të tjerat me radhë?

Pyetja e fundit lidhet me deklaratën që Fondi Monetar Ndërkombëtar nxori në fund të vitit 2021. Kam nënvizuar pjesën që lidhet me sistemin bankar dhe këtu janë lënë disa detyra për Bankën e Shqipërisë. Do të doja të dija nivelin e përmbushjes së këtyre detyrave, pavarësisht se jemi thjesht në 4-mujorin e parë, që janë lënë nga Fondi Monetar Ndërkombëtar për Bankën e Shqipërisë në raport me sistemin dhe për institucionet e tjera në raport me proceset në sistemin bankar shqiptar. Kam parasysh zbatimin e ligjit “Për falimentin”, reformën e tejzgjatur në përmbardim, vetingun atje ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, dua një gjykim tuajin për pjesën e detyrave që janë lënë për Bankën e Shqipërisë dhe nivelin e përmbushjes së detyrave të lëna për institucionet e tjera, përfshirë qeverinë e Republikës së Shqipërisë në lidhje me proceset dhe mirëfunksionimin e sistemit bankar. Këtu po ndalem në një pikë: “Peizazhi në ndryshim i sistemit bankar kërkon rritje të vigjilencës rregullatore dhe mbikëqyrëse. Prania e më shumë bankave me pronësi domethënëse aksionesh nga individë dhe grupe jofinanciare, e rrisin riskun e mungesës së kapitalit, të transaksioneve ndërmjet palëve të lidhura dhe një rritje të ekspozimeve të mëdha. Ne rekomandojmë të vazhdohet të fuqizohet dhe zbatohet kuadri i licencimit dhe mbikëqyrjes, duke përfshirë edhe kontrollin e përshtatshmërisë për aksionerët e rëndësishëm dhe ata me paketa kontrolluese, pronarëve fundorë përfitues dhe menaxherëve të lartë”.

Do të doja të dija, çfarë është bërë konkretisht për këtë pikë?

Faleminderit!

(Drejtimitin e mbledhjes së komisionit e merr kryetari i komisionit, Eduard Shalsi.)

Eduard Shalsi – Ka pyetje të tjera?

Blerina Gjylameti - Zoti Sejko, unë kam një sugjerim: përgjigjet të jepen duke i grupuar pyetjet sipas ngjashmërive që kanë, jo sipas çdo deputeti, sepse kishte disa raste që pyetjet ishin përsëritëse apo edhe zgjerim i pyetjeve dhe informacionit që duhet dhënë.

Nga ana tjetër, në radhë të parë do të doja të thosha se, pavarësisht anës që i përkasim, maxhorancës apo opozitës të kishim një vlerësim për të gjithë pjesën e rolit që keni luajtur në këto 2 kriza, sepse nuk janë kriza të lehta, ku edhe vende më të zhvilluara dhe që kanë një stabilitet financiar shumë herë më të qëndrueshëm se Shqipëria kanë pasur efekte negative.

Do të doja t'ju falënderoja ju dhe ekipin tuaj, por jo vetëm, në mënyrë të posaçme bashkëpunimin që keni pasur me qeverinë shqiptare dhe të gjitha institucionet e tjera për ruajtjen e stabilitetit financiar dhe monetar!

Shpresoj shumë që edhe me krizën e tretë, me të cilën po përballlet jo vetëm Shqipëria, por e gjithë bota, të luani të njëjtin rol që keni pasur deri tani.

Zoti Shalsi, nga ana tjetër, duke qenë se kjo është një nismë që kërkon bashkërelator nga çdo institucion që raporton në Komisionin e Ekonomisë, do të doja që relatorët të ishin së bashku dhe të mos dilnim me dy relacione, sepse në fund të ditës thelbi ose synimi për të cilën ne themi “bashkërelatorë” është pikërisht që nga ana e maxhorancës dhe e opozitës të ketë bashkëpunim për të nxjerrë problematikat kryesore, por nga ana tjetër të kemi nxitje edhe për institucionet që raportojnë në Komisionin e Ekonomisë për të ndjekur më mirë objektivat që vendosen nëpërmjet rezolutave që ne i miratojmë së bashku.

Unë shpresoj shumë që nga sot e tutje të kemi një bashkëpunim më të mirë ndërmjet relatorëve që të mos dalim me dy zëra të ndryshëm.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zonja Gjylameti!

Nga eksperiencia ime gjatë raportimeve që janë bërë nga institucionet e pavarura nuk është se nuk ka pasur komunikim, përkundrazi ka pasur një bashkëpunim, por sigurisht opinionet janë të kundërta. Si çdo eksperiencë e parë, siç është kjo e bashkërelatorëve, nuk do të mund të pretendojmë që në krye të herës që do të ketë një funksionim perfekt të raportit, por unë jam i kënaqur, sepse si eksperiencë e parë do të shërbejë për të kuptuar se çfarë do të bëhet më mirë radhës tjetër.

Dua të falënderoj të gjithë relatorët, anëtarët e komisionit, sepse është një eksperiencë që duhet konsoliduar!

Relatorët, ashtu sikurse e kam thënë, do të kenë një përgjegjësi të shtuar në raport me institucionet që monitorojmë, pikërisht për të mos lejuar raportimin një herë në vit dhe

grumbullimin e shumë çështjeve, por për të pasur një vijueshmëri kontaktesh me institucionet e pavarura.

Zoti Guvernator, fjala për ju.

Gent Sejko – Faleminderit, zoti kryetar!

Së pari, falënderoj të gjithë deputetët për të gjitha vlerësimet pozitive që kishin për institucionin e Bankës së Shqipërisë, për çështjet e ngritura, të cilat janë gjithëpërfshirëse dhe sensitive, si dhe për pyetjet konkrete që u bënë!

Unë do të përiqem t’u jap përgjigje pyetjeve, i mbajta shënim, sipas deputetëve dhe po pati pyetje të përsëritura, pra nëse nuk është e mjaftueshme përgjigjja e parë do t’u jap një përgjigje më vonë.

Pyetjet mbulojnë një gamë shumë të gjerë problematikash, por unë do t’ju jap këndvështrimin e Bankës së Shqipërisë lidhur me ato që mund t’ju them në këto momente, pasi ka edhe çështje ose informacione që janë obligim direkt i Bankës, por disa nuk janë atribut i Bankës së Shqipërisë dhe për të cilat nuk kam ndonjë informacion relevant për t’ju dhënë përgjigje. Pra, unë do t’ju jap përgjigje me aq sa mundem brenda informacionit që kam dhe kontekst ligjor dhe legjislativ që mbulon institucioni i Bankës së Shqipërisë.

Po e filloj me zonjën Tabaku, e cila pati disa pyetje, duke u nisur nga këndvështrimi i saj.

Së pari, më duhet t’ju them që Banka e Shqipërisë është institucioni që përgjigjet për stabilitetin financiar dhe të çmimeve, sepse këto janë dy detyrat parësore. Sigurisht që shqetësimi që ne kemi pasur në lidhje me nivelin e lartë të borxhit publik është shprehur jo vetëm në deklaratat tona publike të Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë, por të shprehura edhe në parlament.

Çdo vit në Komisionin e Ekonomisë kemi dhënë opinionin tonë me shkrim dhe me gojë, me shkrim e kemi detyrim zyrtar dhe ligjor dhe ia dërgojmë Ministrisë së Financave, ndërsa në parlament është bërë si praktikë, që kur zoti Braçe ka qenë kryetar komisioni, vijmë vazhdimisht dhe japim opinionin tonë lidhur me buxhetin e vitit respektiv në të cilin janë të shprehur edhe të gjitha konsideratat me shkrim të Bankës së Shqipërisë, të cilat janë të zbardhura. Hera e fundit ka qenë dhjetori i viti të shkuar ku ne jemi shprehur për shqetësimin lidhur me nivelin e borxhit publik, referuar nivelit të lartë të borxhit, orientimit që duhet të ketë borxhi publik kundrejt uljes së tij, pra konsolidimit fiskal, dhe të problemeve brenda këtij koncepti të përgjithshëm.

Në radhë të parë ka qenë niveli i lartë i borxhit në valutë brenda totalit të borxhit publik, pra ekspozimit të borxhit publik ndaj kursit të këmbimit në rast se do të kishim zhvlerësim të monedhës sonë kombëtare.

Po ashtu, kemi shprehur rekomandimin tonë lidhur me PPP-të, pasi PPP-të duhet të jenë të trajtuara sipas standardeve ndërkombëtare të reflektuara me transparencë. Ne kemi dhënë mendimin tonë pranë qeverisë shqiptare, konkretisht Ministrisë së Financave, duke rekomanduar që duhet të ketë një njësi të specializuar lidhur me trajtimin e PPP-ve, si dhe lidhur me kontabilizimin dhe standardet. Ky është roli i Bankës së Shqipërisë lidhur me nivelin e borxhit publik dhe rekomandimi që ne u bëjmë.

Sa i takon pjesës tjetër lidhur me financimin e qeverisë dhe elemente të tjera këto janë të përcaktuara qartazi në ligj, pra ka limite se sa do të financojë ose jo Banka e Shqipërisë në raste krizash, por ne nuk i kemi kryer.

Gjatë periudhës së krizës jemi shprehur që përveç instrumentit të normës në bazë të interesit kemi përdorur edhe mjete të tjera, siç ka qenë injektimi i likuiditetit në ekonomi nëpërmjet sistemit bankar dhe, nëse do të kishim thellim të krizës, do të bënim programe lehtësimi sasiore, por që nuk i kemi bërë, siç do të ishte blerja e bonove të thesarit të qeverisë shqiptare përsëri nëpërmjet sistemit bankar, pra rritja e masës së financimit. Fatmirësisht, situata u menaxhua me ato instrumente dhe masa që kishim dhe nuk ishte e nevojshme që ne ta financonim qeverinë përtej limiteve ligjore.

Lidhur me nivelin e borxhit ju qartësoj, pasi kjo pyetje ose koment është përsëritur disa herë, që roli i Bankës së Shqipërisë është i qartë. Për politikën fiskale është përgjegjëse qeveria, ndërsa për politikën monetare me ligj është përgjegjëse Banka e Shqipërisë. Politikat ndërthuren për një funksionim sa më të mirë dhe arritje të rezultateve sa më të mira të reformave strukturore në funksion të rritjes ekonomike, por përgjegjësitë janë të ndara. Banka i rekomandon qeverisë, i thotë opinionin e saj, por qeveria nuk i rekomandon Bankës së Shqipërisë lidhur me politikën monetare, sepse ne jemi totalisht të pavarur, nuk kemi pranuar dhe nuk kemi rekomandim lidhur me normën e interesit.

Praktikisht, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë e merr vendimin totalisht në mënyrë të pavarur, kështu që nuk do ta preferonim ose pranonim, por një gjë e tillë nuk ka ndodhur, të paktën për kaq kohë që jam unë, një ndërhyrje në politikën monetare. Ndërkohë,

ndërhyrja e Bankës në politikën fiskale është zyrtare, me shkrim, verbale dhe e komunikuar ndaj publikut.

Sa i takon ndërthurjes së reformave, sepse duhet të jemi të qartë në ndarjen e përgjegjësiave, pasi shpeshherë i përziejmë përgjegjësitë ndërmjet qeverisë dhe bankës dhe pa dashje gabojmë në gjykim kundrejt përgjegjësiave, sepse ajo që është e qeverisë është e qeverisë dhe ajo që është e bankës është e bankës.

Lidhur me nivelin e borxhit, sipas opinionit më duhet t'ju them që është i lartë, por edhe një herë më duhet t'ju përsëris që ne shohim me shqetësim nivelin e lartë të borxhit në valutë brenda nivelit të borxhit, pavarësisht që ka një rezervë valutore të mjaftueshme dhe instrumente mbrojtës kundrejt këtij ekspozimi. Gjithsesi, rekomandimi është që niveli i borxhit në përgjithësi duhet të vijë në ulje drejt konsolidimit fiskal, kjo është e pranuar, po kështu edhe niveli i borxhit në valutë brenda totalit të borxhit, si pasojë e ekspozimit nga kursi i këmbimit.

Pyetja tjetër e zonjës Tabaku kishte të bënte me bankat, me transferimin e kapitalit dhe dividendin. Unë do të preferoja që këtë pyetje ta bashkoja me pyetjen e fundit të zotit Braçe, pasi ndërthuren, lidhur me cilësinë e aksionerëve të bankave, ndërsa pyetjeve të tjera të zotit Braçe do t'i kthehem me detaje kur t'u vijë radha. Ishte edhe një pyetje tjetër e zonjës Koliqi, që lidhej me numrin e bankave, pra të tria këto mund t'i them në një kontekst.

Në radhë të parë ne kemi pasur si objektiv konsolidimin e sistemit bankar, gjë, të cilën e kemi shprehur dhe deklaruar, uljen e numrit të bankave, pasi nga disa studime empirike të kryera numri i bankave prej 16 bankash dhe degësh ka qenë i lartë. Ne kemi dashur të konsolidojmë sistemin bankar, ky ka qenë edhe rekomandim i Fondit Monetar, i Bankës Botërore dhe i institucioneve ndërkombëtare, si dhe të zgjerojmë shtrirjen e sistemit bankar në zonat rurale për të mbështetur sektorin bujqësor, duke qenë se ka pasur nivel të lartë informalitetit. Kjo ishte çështja e parë, por edhe problematika të tjera si fragmentarizimi i tokës, specializim produktesh që mund të kenë institucionet financiare. Përgjithësisht sektorin rural e kanë mbuluar institucione financiare jo banka, të cilat do t'i përmend më vonë, ndërsa bankat janë fokusuar në zonat industriale, kryesisht qytetet.

Ulja e numrit të bankave nga 16 në 11 shihet si një tregues pozitiv, pasi ky ka qenë edhe një nga synimet tona dhe ka pasur sukses. Duhet të kini parasysh se gjatë periudhave të krizave që kemi kaluar, si kriza financiare e vitit 2008 me efekte të zgjatura, kriza greke në tregjet e kapitalit dhe me efekte në ekonominë shqiptare, më pas përmytje, pandemi, tërmet dhe tani

lufta. Gjatë gjithë kësaj periudhe krizash Banka e Shqipërisë është përpjekur që të ruajë stabilitetin monetar dhe financiar, pra të ruajë nivelin e kursit të këmbimit, të inflacionit dhe shëndetin e bankave, duke pasur parasysh që shumica e bankave europiane kishin strategji daljeje, pra janë larguar nga vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe jo vetëm nga Shqipëria, si bankat greke, franceze dhe disa banka të tjera. Këto shifra janë të qarta.

Një nga sfidat kryesore që ne kemi pasur, gjë, të cilën e kam përsëritur vazhdimisht para këtij komisioni të nderuar, ka qenë një sfidë dhe shqetësim serioz për të ruajtur dhe për vazhduar kontributin e sistemit financiar në financimin dhe mbështetjen e ekonomisë me fonde, pra për të luajtur rolin e ndërmjetësit financiar pa prishur cilësinë, duke pasur parasysh që duhej bërë konsolidimi dhe duke qenë në një situatë strategjie daljeje të aksionerëve. Kjo ka qenë një ndër sfidat më të mëdha që kemi kaluar.

Realisht, ne kemi kaluar situata shumë stresuese gjatë këtyre 7 vjetëve për të vazhduar rritjen e kreditimit, ulur kreditë me probleme dhe për të ruajtur cilësinë e aksionerëve, pra ne kemi riparuar makinën gjatë garës, është ndryshuar cilësia e aksionerëve.

Sigurisht që ne do të preferonim të kishim banka me emër, aksionerë me emër, banka sa më të mira ndërkombëtare dhe me historik sa më të mirë. Kush nuk do ta preferonte këtë? Këtë do ta preferonin të gjithë guvernatorët dhe bankat qendrore. Ky është një shqetësim persistent dhe frekuent i përsëritur pranë institucioneve ndërkombëtare, Fondit Monetar dhe Bankës Botërore nga bankat qendrore, jo vetëm nga unë, nga të gjithë guvernatorët e bankave qendrore në mbledhjet vjetore që ne i bëjmë dy herë, por edhe te misioni këtu.

Nga grupet financiare sigurisht nuk ka pasur interes, pavarësisht nga kërkesat që janë bërë gjatë forumeve dhe takimeve të shumta, por ky është tregu, ky është rajoni. Nuk po jua listoj arsyet, por një ndër arsyet kryesore ka qenë kriza e vitit 2008 dhe kushtet shtrënguese të Bankës Qendrore Europiane për bankat e mëdha si Society General, Credit Agricole e me radhë bankat greke, edhe ato ishin banka të mëdha europiane, të cilat u tërhoqën si rezultat i krizës, pasi si pasojë e humbjeve nga kriza ose do të duhej të injektonin kapital shtesë ose duhej të mbyllnin filialet e tyre në disa shtete. U zgjodh e dyta, pasi nuk kishin kapital shtesë dhe kjo solli si pasojë tërheqjen e këtyre grupeve bankare.

Kjo i detyroi shumë shtete të ndërronin aksionerët, por ne, si shumë banka të tjera, u përpoqëm që të ruanim cilësinë e sistemit bankar, duke përzgjedhur aksionerët më të mirë. Në këtë kontekst u rrit përqindja e kapitalit vendas, pra nuk pati aksionerë të tjerë. Me gjithë

përpjekjet tona të shumta, aksionerët e vetëm ishin ata që janë. Çfarë ndodhi, fatmirësisht? Ndodhi ajo që me uljen e numrit të bankave dhe ndërrimin e aksionerëve performanca e sistemit bankar vazhdoi të jetë edhe më e mirë, pasi ka *pro seconds* ndërmjet aksionerëve ndërkombëtarë, pavarësisht nga grupet e mëdha bankare, duke qenë se kriza e vitit 2008 i goditi ato nuk po kontribuonin më me kreditim në ekonominë shqiptare, ndërkohë që aksionerët e rinj ishin më agresivë në të bërit biznes dhe normalisht kreditimi në ekonomi nga një kreditim anemik, që konsiderohej para disa vitesh, sot është në nivelet dyshifrore, kreditimi në ekonomi është në nivelin 12,8% rritje vjetore e kreditimit dhe norma e kredive me probleme ka rënë në nivelin 5,2% nga 25% që ka qenë.

Unë gjykoj që kjo është një histori suksesi deri tani, por se si do të jetë në të ardhmen, kjo është për t'u parë, pasi ka shumë sfida. Deri tani, me uljen e numrit të bankave, ndryshimin e aksionerëve, cilësinë e sektorit bankar, peshën specifike që ka çdo bankë me ndryshimin e numrit të aksionerëve, kemi arritur të rrisim edhe konkurrencën. Pra, është rritur numri i bankave me pesha specifike të barabarta, përveç një banke që është më e madhja, numri i bankave në total me pesha specifike të ngjashme, banka me rreth 6%, është rritur me gjithë këtë proces, duke mos pasur probleme monopoli në sistemin bankar, por një konkurrencë të shëndetshme ndërmjet bankave. Janë 6-7 bankat më të mëdha që janë të ngjashme, si dhe 2-3 banka më të vogla, pra praktikisht ka një sistem me peshe specifike shumë proporcionale.

Pyetja tjetër e zonjës Tabaku kishte të bënte me transferimin e kapitalit. Më duhet t'ju them se transferimi i kapitalit është i lirë. Ne kemi marrë një masë në kuadrin e të gjitha masave për menaxhimin e krizës, praktikisht kemi ndaluar shpërndarjen e dividendit për bankat e nivelit të dytë për disa vite, këtë masë e kemi ende në fuqi, e kemi lejuar për vitin 2019, por për periudhën 2020-2021 bankat nuk mund ta marrin dividendin deri sa ne të shohim performancën e tyre, megjithëse shifrat dhe treguesit tani janë pozitivë në trajtim të përfitueshmërisë dhe të treguesve të tjerë të raporteve cilësore si mjaftueshmëria e kapitalit, treguesit e likuiditetit e të tjera. Gjithsesi bankat e kanë të ndaluar ta marrin dividendin.

Transferimi i kapitalit në Republikën e Shqipërisë është i lirë. Bankat paraqiten me një nivel mjaftueshmërie kapitali, mbi 18%, norma minimale e kërkuar është 12%, pra praktikisht bankat kanë mjaftueshmërisht kapital dhe cilësi portofolësh. Edhe cilësia e portofolave gjatë gjithë kësaj krize, duke pasur parasysh edhe ndryshimin e aksionerëve si pasojë e masave

rregullative, mbikëqyrjes intensive që ne kemi kryer dhe seriozitetit nga vetë bankat, ka rënë në 5% nga 25% dhe ky është një cilësi reale e konfirmuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar.

Fondi Monetar Ndërkombëtar ka dhënë rekomandimet, sigurisht lidhur me çështjen që u ngrit nga zoti Braçe, për sistemin bankar. Natyrisht që rekomandimet për Bankën e Shqipërisë dhe sistemin bankar kanë qenë pozitive. Është e lehtë të shkruash një rekomandim teorik që të ketë cilësi për aksionerët e bankave, po ku janë konkretisht këta aksionarë ndërkombëtarë? Fondi Monetar duhet t'i sjellë këtu që ne t'i përqafojmë dhe t'jua japim sa më shpejt licencën. Problemi është që Fondi e thotë teorikisht, por praktikisht, kur ne e kemi ngritur këtë çështje dikur, na ka thënë: shtetëzujini bankat. Ne nuk mund t'i shtetëzujmë bankat, pasi kemi bërë një revolucion dhe reformë strukturore të mirëfilltë për privatizimin e sistemit bankar, prandaj do të na duhet të monitorojmë mbikëqyrjen dhe të rregullojmë tregun financiar shqiptar me standardet më të mira të Bashkimit Europian dhe brenda termave që ne jemi duke ruajtur për bankat private.

Lidhur me aksionerët e bankave besoj se u përgjigja, sepse ishte një pyetje që e ngriti zonja Tabaku. Aksionerët e bankave janë të filtruar, ka një rregullore për licencimin, ka një ligj në këtë rregullore "Për bankat në Republikën e Shqipërisë dhe rregulloren e licencimit". E gjithë procedura e licencimit është një procedurë, e cila kalon nëpërmjet ekspertëve dhe në përfundim miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë. Praktikisht, analizohen jo vetëm bilancet, por edhe cilësia e aksionerëve, i cili është dhe një ndër kriteret kryesore për të parë dhe për ta vërtetuar këtë. Për momentin nuk gjykojmë që kemi probleme.

Një pyetje e zotit Braçe kishte të bënte me ekspozimin që kanë bankat nga lufta në Ukrainë dhe nga sanksionet e shtrënguara. Në radhë të parë, në përgjithësi, aksionerët e bankave të nivelit të dytë janë të filtruar dhe të ekspozuar deri te përfituesi i fundit, siç e quajmë ne. Informacioni është filtruar thellësisht për të parë origjinën, burimin, cilësinë dhe CV-në e këtyre aksionerëve, por nga ana tjetër është bërë një vrojtim dhe analizë lidhur me ekspozimin e bankave ndaj Rusisë, Bjellorusisë dhe Ukrainës nga lufta në Ukrainë. Nuk kemi banka që të kenë filiale dhe ekspozime. Në Ukrainë niveli i ekspozimit është 0,34% të sistemit bankar, pra është një nivel i papërfillshëm dhe për të cilin bankat kanë provigjinuar dhe praktikisht kjo nuk ndikon në nivelin e mjaftueshmërisë së kapitalit.

Një bankë ka pasur një letër me vlerë, nuk po ia përmend emrin, dhe është investuar në letrat me vlerë të Rusisë, por ajo bankë është mjaftueshmërisht e madhe dhe nuk ia cenon kapitalin. Bankat e tjera, të cilat kanë filiale dhe mund të ndikoheshin indirekt, janë 2-3 banka,

nuk po jua përmend emrat, që kanë filiale në Rusi dhe Ukrainë, të cilat kanë bërë analizat e tyre, por ne ndërkohë kemi bërë një vërtetim dhe analizë të plotë për të parë ndikimin indirekt që mund të kenë nga mëmat e tyre këto banka në operim dhe ka rezultuar që nuk kanë probleme. Përveç 3 testeve të përgjithshme kemi shtuar edhe një analizë specifike për krizën dhe nuk ka rezultuar që bankat të kenë goditje për momentin.

Më pas, nga inflacioni apo përkeqësimi i situatës ekonomike, që vjen nga lufta në Ukrainë, një histori tjetër, kjo është e përgjithshme, por konkretisht...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sa u takon sanksioneve kundrejt bankave dhe individëve, nga analizat që ne kemi bërë nuk kemi problematika konkrete specifike për bankat që operojnë në Shqipëri.

Lidhur me inflacionin, po vazhdoj me çështjet e ngritura nga zonja Tabaku, dhe politikën monetare, është parashikuar që inflacioni të jetë ndërmjet 5 dhe 6%, por gjatë muajit prill doli 6,2%. Pra, inflacioni po rritet me shumë shpejtësi ndryshe nga parashikimet tona.

Edhe në deklaratat e politikës monetare ne kemi thënë që parashikojmë të kemi një inflacion të lartë gjatë vitit 2022, i cili do të vazhdojë të mbetet edhe gjatë vitit 2023, por do të vijë duke u reduktuar. Objektivi i Bankës së Shqipërisë, sipas modelit të politikës monetare norma e inflacionit prej 3%, do të arrihet në gjysmën e parë të vitit 2024. Këtë e thotë modeli i politikës monetare dhe analizat tona.

Tani mund të kemi edhe një inflacion më të lartë, por në përgjithësi parashikimi i GDP-së dhe i inflacionit është në rishikim e sipër nga të gjitha bankat qendrore. Nivelet e larta të inflacionit janë jo vetëm në Shqipëri, por ka edhe shtete që i kanë nivelet shumë më të larta, mbi 7 apo 8%. Norma e inflacionit i ka tronditur qeveritë dhe bankat qendrore të shteteve të mëdha dhe të vogla dhe të gjitha shtetet po rishohin parashikimin ekonomik lidhur qoftë me normën e inflacionit apo me normën e rritjes ekonomike, madje ka filluar të merret në konsideratë nga shtetet e mëdha, por në kuadrin e një analize të padeklaruar, edhe recesioni, si rezultat i goditjes që do të kenë ekonominë nga inflacioni.

Këto gjëra varen nga ecuria dhe zgjerimi i konfliktit në Ukrainë, si dhe efektet që do të ketë lufta në rajon, sepse ka shumë elemente që ndikojnë si nafta, gazi, produktet ushqimore, gruri e me radhë, gjëra që dihen prej jush, por efektet janë për t'u parë. Janë duke u bërë rishikime të vazhdueshme në shifra nga banka qendrore.

Disa pyetje të tjera lidhen me digjitalizimin dhe se çfarë ka bërë Banka e Shqipërisë, ligjin për shërbimet bankare për shtresat në nevojë, si e shohim ne, përfshirja dhe likuiditeti financiar.

Sa i takon digjitalizimit, më duhet t'ju them që ka një strategji 3-vjeçare për sistemin e pagesave drejt Bankës së Shqipërisë. Një nga objektivat kryesorë që ka Banka e Shqipërisë është modernizimi i sistemit të pagesave. Ne kemi edhe Komitetin Kombëtar të **Sistemit të Pagesave...**

praktikisht është miratuar një ligj për shërbimet pagesave pikërisht me këtë qëllim për të hapur tregun dhe për të modernizuar shërbimet e pagesave. Janë plotësuar të gjitha aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji dhe njëkohësisht janë licencuar disa kompani të Fintek-ut. Rregullorja e fundit është *openbanking* për të operuar kooperimin e këtyre kompanive me bankat, në mënyrë që kompanitë e reja të Fintek-ut, që sjellin risi teknologjike, të jenë të ndërthurura dhe të jenë online të kenë *interface* me sistemin bankar. Është një proces i rëndësishëm për ne pasi ka të bëjë me formalizimin e ekonomisë jo vetëm me modernizimin e sistemit të pagesave, por ndihmon në përfshirjen financiare, në rritjen e numrit të llogarive bankare, përveç lehtësirave për qytetarët sidomos për qytetarët që nuk ia kanë bankat afër. Njëkohësisht ne po monitorojmë risqet që ka ky problem për sigurinë. Ne jemi në fillimet e digjitalizimit, pasi digjitalizimi nuk është kaq i thjeshtë, ka nevojë edhe për shumë investime që duhen kryer nga subjektet nga sistemi bankar, kërkon edhe kohën e tij, ne nuk duam të mbetemi pas. Por, nga ana tjetër, duhet kuptuar që nuk mund të krahasohet Shqipëria me shtetet e zhvilluara. Ligji për shërbimet e pagesave është kryer dhe ne po ecim përpara. Në shumë aspekte të strategjisë trevjeçare ka progres në të gjitha bankat që kanë shërbimin *e-banking*, numri i pagesave është rritur lidhur me 12,5% pagesa elektronike nga 4,3. 69% e popullsisë madhore ka llogari bankare nga 40% e popullsisë madhore që kishte në vitin 2017. Pagesat me kartë janë rritur në 16 milionë pagesa në vit, në vitin 2021, pra janë 4 fishuar shifrat e transaksioneve elektronike dhe transaksioneve me kartë janë shumëfishuar në krahasim me trekatër vjet më parë si pasojë e të gjitha këtyre masave rregullative. Të mos harrojmë që ne nuk kemi pasur fare karta debiti dhe krediti dhe fare ATM, para disa vjetësh. Një nga bankat erdhi dhe instaloi ATM dhe pastaj i gjithë sistemi bankar e ndoqi. Të mos harrojmë se kemi qenë një ekonomi keshi më shumë se jemi. Gradualisht duhet të procesojmë më shpejt digjitalizimin, i cili është një nga elemente që shkon në këtë drejtim. Ka shumë përpjekje, së fundi, me qeverinë

shqiptare me e- *albania* po përpiqemi të harmonizojmë platformën e bankave jo vetëm shërbimet e tyre, por edhe shërbimet utilitare ose shërbimet e qeverisë të jenë të ndërthurura. Sektori bankar është treguar i gatshëm. Është ngritur një grup pune me Ministrinë Financave, AKSHI-n, shoqatën e bankave dhe Bankën e Shqipërisë që do të procesojë në këtë aspekt për të pasur transaksione digjitale sa më shumë të jetë e mundur në lehtësim të popullatës.

Lidhur me bujqësinë është një pyetje tjetër. Çfarë bën Banka e Shqipërisë për sektorin bujqësor? Sa i përket sektorit bujqësor është e vërtetë që ka një ekspozim të ulët për shërbimet financiare për sektorin bujqësor. Sigurisht janë më të ulëta, pasi bankat kanë operuar më shumë në qytete, kurse zonat rurale janë mbuluar më shumë nga institucionet financiare jo banka disa nga të cilat janë të specializuara për sektorin bujqësor. Prej vitesh, ka 2-3 dekada që unë mbaj mend që bankat kanë bërë përpjekje serioze për të involvuar sektorin bujqësor, sepse kanë një potencial, e kam parë si potencial, por niveli i lartë i formalitetit, fragmentarizimi i tokës, mos konkurrenca mungesa e incentivave të caktuara ose reformave të caktuara që do të ishin bërë për të incentivuar prodhimin e brendshëm dhe shumë faktorë të tjerë i aknë frenuar pasi bankat janë institucione fitimprurëse, ndërmjetës financiarë dhe sigurisht e bëjnë analizën. Pra, nuk janë institucione bamirësie, por i shohin klientët nga këndvështrimi i riskut. Sigurisht që sektori bujqësor përveç këtyre risqeve ka edhe një specifikë pasi ka edhe një prodhim sezonal dhe bankat shpeshherë nuk kanë garanci të mjaftueshme, kolateralin e tokës, hipotekën. Të mos harrojmë se shumë zona nuk kanë as tokën e regjistruar, banka jep kredi me analizë financiare dhe kolateral që janë dy elementet kryesore, të cilat cedojnë në sektorin bujqësor. Këtë e kanë kompensuar institucionet financiare jobanka. Vlera me afërsi e tepricës së kredisë në sistemin bankar është mbi 150 milionë euro, do të jenë më shumë kërdi të dhëna mbase 200 milionë, por varet nga periudha, pra për sektorin bujqësor. Kjo është e papërfillshme në total me të gjithë sektorët e tjerë. Por të gjitha këto janë pengesa.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është 55 %. Natyrisht që është e ulët. Kjo është e ditur dhe ka shumë përpjekje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtë nuk mund ta them ekzaktësisht tani, sepse nuk e kam shifrën e ndarë prodhim a përpunim. Është totali.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ky është totali i kredive për bujqësinë. Mund të jetë edhe më e lartë. Nuk i kam shifrat e detajuara për bujqësinë.

Gjithsesi është e ulët.

Eduard Shalsi – Është një pikë që do ta mbajmë shënim dhe thashë që do të jemi në kontakt të vijueshëm.

Gent Sejko – Sa i përket kredisë për individët është 45 milionë euro. Kredia për individët është rritur 45 milionë euro ose 15%.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anila Denaj – Absolutisht nuk dua të ndërhyj, por, siç e diskutuam edhe dje, kur flitet për një grup është mirë ta ezaurojmë atë grup që të dalë edhe konteksti i plotë. Kur flasim për kredinë për individ fokusi ishte rritja. Sa është specifikisht rritja për individët në sektorin bankar, mund të mos e kemi sot, por ta kemi në komunikimet që vijnë, sa është e sektorit jobankar dhe sa e cilësore është kjo rritje, sepse te kredia për individë unë edhe nga eksperiencia e mëparshme gjykoj se ka risqe më të shtuara dhe po të jetë ky 45% një peshë më e rritur nga sektori jobankar, prandaj e bëra pyetjen. Pra, do të doja të rishikoja tre komponentët: sa është rritja për individë nga sektori bankar dhe sa është kredia në vonesë për individët nga sektori bankar për t'i bashkuar bashkë dhe për të thënë nëse është e shëndetshme apo ka rreziqe. Mund të mos e keni sot shifrën, por thjesht për të konkluduar pyetjen.

Gent Sejko - Rritja është 45 milionë euro, ose 15%, megjithatë unë mund të them se shifrën jashtë sektorit bankar nuk e kemi. Kemi bërë disa vrojtime për kredinë informale dhe na ka dalë jo shumë shqetësuese jo problematike, gjithsesi ekziston tregu formal, kurse brenda sistemit financiar rritja për individët është e konsiderueshme dhe kryesisht përfshihen kreditë hipotekore dhe konsumatore. Si kreditë hipotekore, si kreditë konsumatorë kanë një cilësi të mirë në performancë, pra në kthim. Kreditë e dhëna së fundi për individët nuk janë kredi problematike, madje janë cilësisht më mirë se kreditë për bizneset. Kemi një rritje të qenësishme në kredinë për individë, konsumatorë dhe hipotekore. Kredia konsumatore përfshin të gjitha llojet e kredive që merren, që shpeshherë janë të pakoletarizuara brenda një niveli 1 milionë -2 milionë lekë të rinj, ndërkohë që kredia hipotekore ka të bëjë me kreditë për pasuritë e patundshme apartamente, por edhe prona të tjera. Është një segment i qëndrueshëm i tregut financiar. Po më thonë se shifra e bujqësisë duhet të jetë më e madhe. Nëse ka kërkesa për informacion të detajuar unë jam gati t'i zbërthejmë dhe t'ia japim informacionin, por me një

bisedë të vetme me një takim është e pamundur të sqaroj, pasi nuk më kujtohen, prandaj është mirë që me një relacion të plotë t'ju sqaroj, pasi të gjitha shifrat i kemi.

Jam ende te relacioni i zonjës Tabaku, pasi kishte pyetje. Jemi të forcimi i lekut kundrejt euros dhe deeuroizimi. Është edhe një pyetje tjetër për deeurizimin. Ne kemi një kurs, Banka e Shqipërisë nuk ndërhyr nuk ka qëllim kursin e këmbimit. Ne nuk kemi një objektiv, të caktuar që të synojmë të themi që e duam kursin kaq ose kaq, ta forcojmë ose ta dobësojmë. Për sa kohë është regjimi i lirë i kursit të këmbimit është kërkesë oferta, është tregu që e përcakton. Ky regjim i lirë i kursit të këmbimit konsiderohet shumë pozitiv si amortizues automatik i goditjeve që vijën për ekonominë, por sigurisht që ka anët pozitive dhe anët negative. Kur kursi forcohet, pra kur leku forcohet dhe euro dobësohet ndikohet negativisht tek ekspertuesit ose tek ato që i aknë të ardhurat në euro dhe e kundërta kur zhvlerësohet leku ndikon në të kundërt, pra ndikon negativisht tek ata që kanë të ardhurat në lekë dhe pozitivisht tek ata që i aknë të ardhurat në euro. Tani ne nuk kemi objektiv, por nga ana tjetër Banka e Shqipërisë e ka të përcaktuar qartë ndërhyrjen në kursin e këmbimit se kur kryhet. Kur ka spekulime, të cilat ndikojnë në zgjerimin spretheve, këto janë të përcaktuara qartë me rregullore, kur goditet objektivi i inflacionit dhe kur ka ndërhyrje, por jo për qëllime kursi për blerje për të rritur rezervën valutore. Këto janë të përcaktuara qartë. Ne kemi ndërhyrë për kursin në dy momente gjatë krizave të fundit. Në fillim të krizës së pandemisë pati një spekulim në treg, kursi i zhvlerësua shumë shpejt për një periudhë njëjavore, Banka e Shqipërisë ndërhyri dhe e komunikoi ndërhyrjen, tre muaj me vonësë u dha shifra pasi ndikojmë në treg, por e bëjmë transparente sipas rregullores më pas. Njëkohësisht ne kemi ndërhyrë edhe sapo filloi kriza e luftës në Ukrainë. Pati një zhvlerësim kursi, i cili na rezultoi se nuk ishte si pasojë e blerjeve dhe shitjeve në treg, por ishte pasojë e faktorit psikologjik. Ndërhyrja e stabilizoi tregun. Pjesa tjetër kursit është treg i lirë i kursit të këmbimit dhe duhet të jemi të qartë dhe publiku duhet të jetë i qartë se Banka e Shqipërisë nuk ndikon. Kursin e ndikon tregu dhe blerjet dhe shitjet e valutës, ndërkohë që politika e deeuroizimit është një politikë e ndërmerrë nga Banka e Shqipërisë dhe qeveria e Shqipërisë me qëllim rritjen e përdorimit të monedhës vendase, për dy qëllime: së pari, për qëllime konkrete të eficiencës së reformave strukturore financiare që ne ndërmarrim. Në radhë të parë për Bankën e Shqipërisë rritja e përdorimit të monedhës vendase rrit transmetimin e politikës monetare. Sa kohë që ne kemi një nivel të lartë deeuroizimi në sistemin financiar, ulja ose rritja e normës bazë të interesit që është instrumenti ynë kryesor ndikon vetëm mbi 50% të aktiveve të bankave. Nëse do të

ishite mbi 100% efekti i transmetimit të politikës ndërkombëtare do të ishte edhe më i lartë. Nga ana tjetër ndikon edhe për ruajtjen e stabilitetit financiar. Për sa kohë që ne kemi një ekspozim të lartë kreditimi në euro për klientë që i gjenerojnë të ardhurat në lekë ka një rrezik të madh për sistemin financiar në rast të zhvlerësimit të kursit të këmbimit. Pra, nëse klientët do të duan të kthejnë kreditë në euro dhe iu zhvlerësohet e ardhura në lekë do të falimentojnë për të paguar këstet dhe kjo do të transmetohet tek sistemi bankar dhe sistemi financiar. Janë histori të ngjashme që janë parë në shtete si Zvicra, Hungaria dhe shumë shtete të tjera që kanë pësuar goditje serioze në banka, deri në mbyllje bankash. Deri sot ne kemi qenë me fat është mirëmenaxhuar, por problemi është aty, për më tepër që niveli i ekspozimit të kursit të këmbimit nuk ndikon vetëm te sektori financiar, tek biznesi individët sektori financiar por ndikon edhe te borxhi i qeverisë që unë e përmenda. Për të gjitha këto arsye ne kërkojmë të rritet përdorimi i monedhës vendase. Pra, për të mitiguara këto rreziqe dhe për të rritur transmetimin e politikës monetare. Kjo duhet kuptuar. Masat tona janë masa që mund të bëjë një bankë qendrore, që kanë lidhje me ndryshimin e normave për rezervën e detyrueshme, ndryshimin e normave për likuiditetin në Bankën e Shqipërisë dhe për rritjen e transparencës ndaj individëve që pohojnë në banka që shpeshherë marrin gabimisht kredi në euro kur mund ta marrin shumë mirë në lekë dhe të ardhurat i kanë lekë, pasi disa banka kanë synimin por rritjen e kreditimit në euro, si pasojë e menaxhimit të likuiditetit të tyre. Në këtë aspekt ka pasur rezultat pozitiv, pasi kredia në lekë. Kjo është një arritje shumë e mirë e politikës sonë të deeurizimit. Ju thatë se nuk ka rritje, por për Bankën e Shqipërisë ka rritje, pasi kredia në lekë nga 80% kredia në euro është ulur nga niveli 80% i ekspozimit të totalit të kredisë që ishte në euro, sot është më pak se 50%. Pra gradualisht është rritur kreditimi dhe kjo rrit edhe transmetimin e politikës sonë monetare.

Pastaj pjesa tjetër i takon masave që duhet të marrë qeveria për të ulur deeuroizimin në ekonominë reale. Kjo nuk do të thotë që ne të shmangim euron, pasi ne partnerët tanë tregtarë i kemi në euro. Shtetet fqinje, edhe partnerët më të mëdhenj tregtarë Itali, Greqi, import eksportet i kemi në euro dhe natyrisht që do të ketë flukse hyrëse. Investimet e hyja direkte janë në euro, remitancat ne i presim në euro, turizmi sjell euro. Pra të gjitha këto kanale formale ndikojnë për prurje të larta eurosh në ekonominë shqiptare, prandaj dhe kemi një lek të fortë dhe euro të dobët në terma formale. Por nga krahu tjetër nuk ka arsye të përdoret euro për shitblerje për produkte. Ne ishim në Maqedoni para pak ditësh dhe paguam me euro, por na kthehej kusuri në monedhën vendase, ose nuk pranohej blerja dhe shitja në tregun me pakicë ne euro, ndërkohë që ne në

Shqipëri e vendosim edhe tek trau. Shpeshherë shohim dokumente zyrtare në euro. Pra, së pari, institucionet ligjzbatuese duhet të shmangin, të punojnë me monedhën vendase, sepse nuk është për çështje patriotizmi, por është për çështje efektiviteti, politikash makroekonomike dhe reformash strukturore financiare në funksion të stabilitetit financiar dhe monetar dhe të rritjes ekonomike.

E kemi thënë vazhdimisht do të duhet reaguar nuk e kuptoj pse ne nuk reagojmë si shtetet fqinje. Kontratat duhen bërë në monedhën vendase. Te noterët nuk ka pse të bëhen në euro. Pra, ne nuk pengojmë transaksionet financiare, nuk synojmë të forcojmë ose zhvlerësojmë euron ose lekun, por ne synojmë të bëjmë atë që bëjnë të gjithë pa shkaktuar humbje tek agjentët ekonomikë por njëllon si në çdo shtet të botës kjo është diçka që mund të bëhet.

Sa i përket financimit të sektorit të ndërtimit dhe pastrimit të parasë, këto janë tema që kërkojnë kohën e tyre. Koha mbase nuk na del, por unë do t'i prek dhe do të kthej përgjigje. Të gjitha çështjet janë të rëndësishme, por me një çështje të vetme mund të harxhojmë dy orë.

Pra lidhur me financimin e sektorit të ndërtimit. Ky financim në rrugë formale ka pasur rritje. Kjo është e lidhur edhe me individët që ne thamë.

Nuk kemi të dhëna për financimin e sektorit të ndërtimit. Banka e Shqipërisë nuk ka të dhëna. Banka e Shqipërisë është përgjegjëse lidhur me monitorimin dhe mbikëqyrjen e bankave raportimin që merr nga bankat e nivelit të dytë. Sigurisht që bëhen disa vrojtme statistikore, që ne bëjmë për punën kërkimore shkencore për të parë se sektori informal mund të ndikojnë në sektorin informal për zbatimin e politikave tona monetare dhe makropotenciale, por nuk kemi një shifër. Sigurisht që agjencitë e tjera ligjzbatuese të ndërthurura me Bankën e Shqipërisë në raport me pastrimin e parasë duhet të kryejnë detyrën e tyre, por të monitorojnë në kanale dhe forma të tjetra nëse ka forma të pastrimit të parasë në sektorin e ndërtimit dhe të na informojnë ne si Bankë e Shqipërisë për të parë në se ka penetrim në sistemin bankar.

Nga krahu tjetër ne monitorojmë klientët e bankave për origjinën dhe burimet e të ardhurave dhe sigurisht që ushtrojmë rolin tonë dhe ndërthurim punën tonë me agjencitë e tjera ligjzbatuese për këtë qëllim. Pra, kemi Drejtorinë e Pastrimit të Parave, Shërbimin Informativ, Krimin Ekonomik, kemi shumë institucione të tjera ligjzbatuese, të cilat janë përgjegjëset dhe duhet shkëmbyer informacioni. Ne si institucion brenda kuadrit tonë ligjor zbatojmë detyrën tonë dhe e shkëmbejmë informacionin. E kemi të raportuar. Nga Komisioni i Ekonomisë, por edhe nga të gjithë aktorët e tjerë duhet parë funksionimi pasi nuk është atribut i Bankës së Shqipërisë

parandalimi. Unë e përmenda në fjalën time kur fola ku konsiston roli i Bankës së Shqipërisë për parandalimin e pastrimit të parave.

Po kështu edhe për monedhën krypto. Për këtë monedhë dua ta theksoj dhe e kam theksuar gjithashtu e përsëris asnjë nga bankat qendrore nuk është eksportuese e aktivitetit në krypto, pasi roli i bankës qendrore është stabiliteti i çmimeve është politika monetare e stabilitetit financiar. Në raport me politikën monetare bankat qendrore, këto janë fundamentale, janë koncepte bazike të pandryshueshme të funksionimit të bankave qendrore. Emisioni i kartëmonedhës kryhet nga banka qendrore dhe natyrisht nëse ka entitete të tjera paralele që emetojnë pa kontroll natyrisht që bankat qendrore në të gjithë botën nuk janë në favor, pasi nuk ka në kontroll qarkullimin dhe emisionin e parasë. Së dyti, në raport me stabilitetin financiar janë rreziqe që kanë të bëjnë me sigurinë e të dhënave, pastrimin e parasë, me spekulime të ndryshme, të cilat bankat qendrore si autoritete rregullatore mbikëqyrëse përgjegjëse për stabilitetin financiar i shohin me frikë dhe me shqetësim. Sigurisht që asnjë nga bankat qendrore sot në botë, kjo dihet nuk është në suport dhe nuk e sheh me këndvështrim mbështetës aktivitetin e kriptos.

Që të jemi të qartë se vazhdimisht bëhen pyetje, normalisht bankat qendrore kanë filluar punën për të mos qenë më prapa kohës, pra siç e përmendi zoti Braçe që ka komente, këto komente janë komente ndërkombëtare që janë prapa janë më konservatore dhe teknologjia po ecën, bankat qendrore aknë filluar të bëjnë studime për emetimin për misionin e emetimit digjital nga vetë banka qendrore. Pra, atëherë bankat qendrore do të kishin monedhën e tyre digjitale dhe historia do të ishte ndryshe. Sigurisht që ka shumë shtytje de analiza, por edhe banka e Anglisë, Banka Qendrore Europiane ka thënë se jo para vitit 2025 ne do të kemi një rezultat. Tani vetë bankat qendrore në shtet më të mëdha të botës thonë që jo para vitit 2025 do të kemi një rezultat. Sigurisht që ne po punojmë dhe po shohim se çfarë po bëjnë ata por këto janë zhvillime teknologjike që ne nuk do të shpikim rrotën do të kopjojmë ose do të përshtatim ato që bëjnë bankat qendror më të mëdha. Por natyrisht që monedhën krypto për këto arsye fundamentale unë e thashë që asnjë nga bankat qendrore nuk e sheh si instrument si moment, por e sheh me frikë dhe bëjmë thirrje që individët që investojnë në këto platforma të jenë të kujdesshëm pasi janë të ekspozuar nga rreziqet, pastaj është risk i individit nëse e merr ose jo përsipër një investim të caktuar. Sigurisht, ligji nuk e ka ngarkuar Bankën e Shqipërisë si institucion licencues përgjegjës, por ka një ligj, i cili, me sa di unë, është bërë pikërisht për të

frenuar këto risqe, ka caktuar Agjencinë e Mbikëqyrjes Financiare dhe Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, si dy institucione licencuese.

Ne nuk i kemi bërë kurrë bisht. Ky është qëndrimi i Bankës së Shqipërisë. Nga këndvështrimi ynë ne monitorojmë ato institucione që licencojmë, nëse ka ekspozime.

Nuk ka aktivitete të monedhës krypto të ndërthurur me bankat e nivelit të dytë në Shqipëri dhe vetë bankat janë koshiente për këto risqe, edhe ato vetë janë kundërshtuese, por në treg ekzistojnë këto platforma, ku individët duhet të jenë të kujdesshëm, kushdo që do të marrë riskun për të investuar, e merr vetë, por të jemi të qartë që këtu ka disa risqe për të cilat ju fola.

Ndërsa për sa i përket parandalimit të pastrimit të parave, që ekziston edhe ky rrezik, Banka e Shqipërisë së bashku me të gjitha institucionet e tjera ligjzbatuese duhet të harmonizojnë përpjekjet për të qenë eficientë dhe për t'i parandaluar.

Lidhur me amnistinë fiskale, ishte një pyetje tjetër e zonjës Tabaku, e cila u largua, por unë do të përgjigjem, kjo ka kosto dhe benefit, sigurisht. Si benefit, në radhë të parë, amnistia fiskale do të rriste injektimin e likuiditeteve në ekonomi, por benefiti më i madh që ne shohim është formalizimi i ekonomisë. Pra, amnistia fiskale do të ndikonte në formalizimin e ekonomisë, pasi do të rritej numri i llogarive bankare dhe i deklarimeve të fondeve financiare të deklaruara, që do të ndikonin edhe në rritjen e të ardhurave në buxhet, pasi amnistia fiskale shoqërohet me një taksë për buxhetin.

Në krahun tjetër, amnistia fiskale ka dy rreziqe kryesore, të cilat duhen mbajtur parasysh. Në radhë të parë, është shmangia e kriminalitetit dhe e korrupsionit në këtë deklaram, pra duhet të jemi të qartë, ligji duhet të sigurojë që të shmangen paratë e ardhura nga kriminaliteti ose nga korrupsioni qoftë politik apo çdolloj tjetër korrupsioni.

Në radhë të dytë, duhet shmangur koncepti që do të ketë përsëritje amnistish. Pra, bërja e amnistisë duhet të jetë e qartë, ajo bëhet njëherë e përgjithmonë, duhet të jetë e mirëmenduar që të jetë funksionale, duhet të shmangë paratë e pista, fondet kriminale dhe korrupsionin dhe, njëkohësisht, duhet të shoqërohet me forcimin e masave formalizuese nga institucionet ligjzbatuese, si: Ministria e Financave dhe të gjitha institucionet e tjera që mbledhin të ardhurat, në mënyrë që pas amnistisë niveli i evazionit fiskal të jetë sa më i ulët. Pra, të kemi rezultate konkrete, të mos bëjmë amnisti kot dhe pastaj të vazhdojmë me po të njëjtin nivel. Pra, të ketë eficiencë amnistia, të kuptohet që kjo amnisti bëhet njëherë e përgjithmonë. (Ndoshta pas 100 vjetësh mund të bëhet amnisti tjetër, nëse bëhet).

Ky është koncepti teorik që ne kemi, pasi ne nuk kemi një draft amnistie që ta shohim e të flasim konkretisht. Në baza kryesore, këto janë opinionet e Bankës së Shqipërisë lidhur me amnistinë fiskale në mënyrë parimore.

Lidhur me stres-testet, që pyeti zonja Tabaku, dhe shëndeti i sektorit, u përmend në fjalën tonë, sektori bankar ka tepriçë likuiditeti, ka një normë mjaftueshmërie kapitali të lartë dhe paraqitet i shëndetshëm me të gjitha bashkimet e bankave. Fatmirësisht, edhe me ndryshimet e aksionereve sektori bankar është i sigurt dhe i shëndetshëm, me normë të lartë mjaftueshmërie, me nivel të ultë të kredisë me probleme dhe me tepriçë likuiditeti. Stres-treset tregojnë që janë disa standarde që, edhe në rastin e skenarit më të keq të ekonomisë, bankat përsëri do të rezistojnë. Dy-tri banka të vogla do të kishin nevojë për injektim të vogël kapitali, por gjithsesi nuk është problematikë. Për situatën aktuale që ne jemi, sistemi bankar paraqitet i shëndetshëm, me likuiditet dhe me mjaftueshmëri kapitali.

Lidhur me kostot e bankave dhe konsumatorët, çfarë ka bërë Banka e Shqipërisë, kjo është një histori e vazhdueshme, tregu është konkurrues dhe çmimet i përcakton tregu.

Në radhë të parë, Banka e Shqipërisë do të bëjë të sigurt transparencën, pra ne jemi përgjegjës dhe kemi një rregullore për transparencën. Bankat dhe institucionet financiare jobanka, zyrat e këmbimit valutor, të gjitha institucionet që licencohen, duhet të mos shkelin rregulloren e transparencës, duhet të bëjnë transparente çmimet, komisionet, normat e interesit, kursin e këmbimit e gjithçka. Sigurisht, në kontrata duhet të jenë transparente kur shkruajmë me klientët, kjo është e para. Pastaj, brenda kontureve se sa janë çmimet, ka shumë faktorë dhe elemente, të cilët justifikojnë arsyen pse mund të jenë çmimet e larta apo të ulëta.

Në radhë të parë, niveli i riskut diskutohet për normat e kredisë, pavarësisht që ka rënë, si pasojë e politikës monetare, simuluese të Bankës së Shqipërisë, por edhe Bankës Qendrore Europiane, pasi edhe kreditë në euro janë me normën e Euribor-it, që është e ulët, kanë rënë normat e interesit si pasojë e politikave monetare, por sidoqoftë ka një normë interesi, që është më e lartë, e ponderuar me koston e riskut. Sa më të mëdha të jenë rreziqet e vendit, aq më të mëdha janë normat e interesit ose kostot e tjera, pasi bankat duhet të mbulojnë humbjet nga rreziqet.

Shqipëria është një vend që ka nivel të lartë informaliteti, ka kosto më të lartë, nuk krahasohet norma e interesit të Shqipërisë me normën e Gjermanisë, ne shpeshherë gabojmë kur bëjmë krahasime të kësaj natyre.

Lidhur me garancinë sovrane, sa kanë qenë, garanci sovrane ka qenë garancia 1 dhe 2, e para ka qenë për bizneset, që jepen nga qeveria për të tejkaluar pasojat e pandemisë. Garancia ka funksionuar, pra ka pasur një efekt, kanë përfituar 760 biznese, kanë qenë rreth 100 milionë euro ose 12 miliardë lekë të dyja garancitë bashkë.

Pra, totali i garancive sovrane është aplikuar mbi 760 biznese me një shumë prej 100 milionë eurosh ose 12 miliardë lekë. Gjithsesi, shifrat e garancisë sovrane ne i kemi përmendur disa herë dhe këto janë të tejkaluara. Ajo që duhet thënë është që masat e ndërmarra për kapërcimin e krizës si nga qeveria shqiptare, me garanci sovrane, ashtu edhe nga Banka e Shqipërisë, me moratoriume për shtyrjen e kësteve të kredisë dhe për injektimin e likuiditeteve, kanë rezultuar eficiente edhe më shumë se ç'ë mendonim ne. Ne kishim pritshmëri për një rënie më të fortë ekonomike, ndoshta në nivelin 12%, për falimentime më të mëdha në nivele biznesesh të sektorit financiar, por që nuk ndodhen. Pra, përsëri sektori financiar e menaxhoi dhe doli me fitim, por ne kishim pritshmëri edhe për rritjet e kredive me probleme në nivele më të larta, 12-15%, ndërkohë që nuk ndodhi.

Të gjithë treguesit e tjerë makro janë të ditur dhe ne kemi theksuar që ne e kemi tejkaluar edhe Fondin Monetar. Banka Botërore e ka certifikuar këtë opinion, dhe ata vetë kanë dalë me këtë opinion, që efektet e krizës nga pandemia dhe tërmeti janë tejkaluar. Rritja ekonomike e vitit 2021 e konfirmoi. Pra, ne e kemi tejkaluar me masat e ndërmarra si nga qeveria shqiptare dhe nga Banka e Shqipërisë. Harmonizimi dhe koordinimi kanë bërë që efektet e krizës të ndiheshin më pak se çdo të ndiheshin pa u marrë këto masa.

Tani kemi hallin tjetër, që është inflacioni, lufta në Ukrainë dhe kemi filluar një luftë tjetër, këto janë të tejkaluara, por flasim për vitin 2021, ndaj i përmendim.

Lidhur me pyetjet e zonjës Denaj, deorizimi e përmenda se cili është qëllimi i deorizimit dhe e tejkalojmë.

Portofolin e kredisë për bujqësinë e përmendëm gjithashtu.

Lidhur me aksesin në financë në bujqësi, është i ulët për këto arsye: informaliteti, digjitalizimi, format e reja të pagesave nga celulari. Sigurisht që do të përfitojë edhe sektori rural, pasi këto institucionet e reja të Fintek-ut mund të kenë një efekt pa diskutim shumë herë më të madh.

Lidhur me institucionet me jobanka, e thashë shifrën për individët.

Kredia informale e përmenda, që nuk kam asnjë informacion.

Sa është rritur kredia në vitin 2021? Këto janë pyetjet e zonjës Denaj. Kredia në vitin 2021 është rritur me 12,8% e fundit me bazë vjetore.

Rritja e kreditimit ka qenë me bazë të gjerë dhe ndryshimi i aksionerëve të bankave, konsolidimi i sistemit bankar, masat rregullative që kemi marrë, kërkesa e tregut, reagimi i agjentëve ekonomikë, të gjithë faktorët bashkë kanë bërë që të kemi një rritje të mirë kreditim. Pesha më e madhe e kredisë është rritur në lekë më shumë sesa në euro dhe kredia në total është rritur mjaftueshmërisht mirë, sidomos për një kohë krize. Ne kemi parashikimin që të mbajmë këtë nivel rritjeje kreditimi, rreth 10%. Nëse edhe në këtë periudhë krize do të mbajmë këtë nivel të kreditimit në ekonomi, gjykojmë se kjo është një situatë shumë e mirë për sektorin financiar, por edhe për ekonominë në përgjithësi. Sidoqoftë, kredia ka ardhur me një rritje të mirë.

Kalojmë te pyetjet e zonjës Koliqi.

Në lidhje me pyetjen për uljen e nivelit të bankave, e përmenda.

Lidhur me aksionerët, e përmenda, aksionerët janë të publikuar, të ditur, të analizuar. Në një rast abuzohet në një bankë të caktuar për një aksioner me origjinë ruse, por që është qytetar i një shteti tjetër, është i analizuar, është i filtruar, nuk ka ekspozim grupi, grupi është anëtar banke i Bashkimit Europian, nga mbykqyrur ECB-ja, e licencuar nga kjo bankë. Pra, të gjitha procedurat dhe ligjet tona nuk kanë asnjë kufizim dhe nuk shikojmë ndonjë risk ose ekspozim të këtij aksioneri të vetëm të kësaj banke, që në peshën totale ka shumë aksionerë të tjerë me të rëndësishëm, t'i krijojë humbje bankës ose kosto reputacionale lidhur me konfliktin.

Përtej kësaj, nuk kemi asnjë aksioner tjetër, që të na japë indicie qoftë për kompromentim në CV-në e tij, qoftë për përfshirje në pjesën e Ruisë nga lufta në Ukrainë. Këto janë rezultatet që ne kemi për momentin, për fat, kemi edhe 11 banka dhe aksionarët i kemi më kollaj t'i mbikëqyrim.

Lidhur me rritjen ekonomike, nga 4,2% e kemi ulur parashikimin në 3,4% për vitin 2022 dhe nga 3,3 e kemi çuar në 2,7% rritjen ekonomike të vitit 2023, sipas modeli tonë të politikës monetare të Banka e Shqipërisë. Në varësi të shifrave që do të kemi, do të bëjmë edhe rishikimin në ulje ose në ngritje, por gjithmonë e kemi thënë, çdo gjë është e kushtëzuar me ecurinë e konfliktit në Ukrainë dhe pastaj me të gjithë elementet e tjera, që kanë të bëjnë me çmimet e naftës, energjisë, grurit e me radhë.

Në lidhje me pyetjen për numrin e punonjësve të Bankës së Shqipërisë, rritjen e numrit të punonjësve dhe argumenti, Banka e Shqipërisë, ju e morët krahasimin me disa vite më parë,

duke pasur parasysh që tregu financiar është rritur mjaftueshëm, me mua këtu është drejtori i Mbikëqyrjes dhe vetëm ky departament në krahasim me kohën kur unë kam qenë është trefishuar në krahasim me vitin 2002.

Për sa i përket pyetjes për numrin e institucioneve të licencuara, numri i problematikave, problematikat e Bankës së Shqipërisë mund të shihen nga raportet vjetore, të cilat tregojnë rritjen e aktivitetit të bankës, rritjen e tregut financiar, rritjen e problematikave dhe involvimit, numrin e punonjësve, njëkohësisht, edhe pagat e bankës. Herën e parë që unë jam përballur në Komisionin e Ekonomisë me një deputet të nderuar, më është kërkuar që të shihet niveli i pagave dhe i privilegjeve të Bankës së Shqipërisë. Pikërisht për këtë ne kemi bërë një studim për të parë nivelin e pagave të Bankës së Shqipërisë, të administratës publike dhe sektorit privat krahasuar me nivelin e pagave të bankave qendrore të rajonit dhe me disproporcionet që kishin edhe bankat e tjera në raport me industrinë dhe në raport me grupet krahasuese. Morëm kompaninë “Deloitte” për ta bërë këtë studim, në mënyrë që të ishim të pavarur, që të mos ishte studimi Bankës së Shqipërisë, që të paragjykohej dhe, mbi të gjitha, edhe unë vetë desha të dija ku ishim ne në krahasim me vendet e tjera në nivelin e pagave. Bankat qendrore kanë nivele më të larta pagash kudo, duke filluar nga SHBA-të, pasi nuk janë pjesë e buxhetit të shtetit, por janë institucione financiare me buxhetin e tyre, kanë ekspertizë të veçantë, kanë rol të veçantë për stabilitetin makro-ekonomik monetar dhe financiar të vendit dhe kjo nuk është situatë specifike, por është situatë ndërkombëtare standarde. Nëse ju gjeni një shtet të ndryshëm, ma thoni ta kemi si shembull, por kjo është një situatë e ezauruar dhe e ditur tashmë.

Gjithsesi, unë po e përsëris, ajo që doli nga raporti ishte që Banka e Shqipërisë ishte në nivele më të ulta nga shtetet e rajonit në atë kohë. Pra, flasim më të ulta në raport edhe me institucionet e tjera, në terma relativë, se në terma absolutë po e po. Pra, nuk na rezultoi për të bërë një reformë për uljen e pagave në Bankën e Shqipërisë. Këtë raport ne mund ta bëjmë publik dhe ju mund ta shikoni po të doni. E rëndësishme është që ne të ruajmë një cilësi të nivelit të ekspertizës, nivelit të profesionalizmit dhe të integritetit në institucionin e Bankës së Shqipërisë dhe të kemi një nivel të caktuar burimesh njerëzore. Pra, e rëndësishme është të ruajmë cilësinë e ekspertëve tanë, të mos na ikin, pasi shpeshherë sistemi bankar, në thonjëza, na i merr punonjësit më cilësorë. Unë vetë dikur e kam lënë Bankën e Shqipërisë dhe kam shkuar në sistem bankar për shumë vite, pikërisht për arsye page, kam gjetur një pagë dyfish më të lartë se aty.

Lidhur me pyetjen ish-hotel Dajtin, që ka mbetur i rrënuar, në fakt, ju keni të drejtë për konstatimin, ajo mbulesa është e shëmtuar, por de facto kanë mbaruar rreth 85% e punimeve, nuk është më i rrënuar, por është totalisht i rinovuar, është afër përfundimit dhe parashikojmë që objektin e dytë të Bankës së Shqipërisë ta mbyllim brenda këtij viti. Rreth muajit shtator është objektivi që ne parashikojmë të fusim punonjësit tanë në atë ambient, por pandemia, tërmeti dhe veçanërisht edhe kjo kriza e fundit krijuan probleme, të cilat bënë një shtyrje të punimeve.

Tërmeti e shkërmoqi në esencë gjatë ndërtimit dhe ne u detyruam të merrnim Institutin e Sizmikës që të bënte një vlerësim. Shumë elemente të tjera që janë bërë në vlerësimin e objektit, është ripërforcuar objekti, i cili është monument kulture i kategorisë së parë dhe nuk mund të shembej apo të ndërtohej nga fillimi, pasi, nëse do të bëhej në këtë formë, do të kishte përfunduar shumë më herët, objekti duhej mbajtur pa prekur siç ishte dhe ne jemi përpjekur ta ruajmë objektin në të gjitha parametrat, pa shembur asgjë. Janë qepur me një metodologji të re të ndërtimit të gjitha kolonat nga fillimi, janë lidhur dhe pastaj është bërë rinovimi dhe ruajtja e objektit siç ka qenë. Gjithsesi, janë shumë elemente, që janë ndjekur dhe shumë sfida inxhinierie, se ne nuk jemi as institucion inxhinierie. Fatmirësisht objekti është drejt përfundimit, pothuajse ka përfunduar i tëri brenda dhe po bëhen rregullimet rrotull. Parashikojmë që në vjeshtë objekti të jetë funksional, ku do të akomodohen me zyra edhe pjesa tjetër e punonjësve 200-250 punonjës. Kati i parë do të mbetet i hapur për publikun, pasi hollet nuk kanë ndryshuar, salla e konferencave dhe libraria e madhe do të jenë në dispozicion të publikut. Kemi bërë një ndarje, zyrat ku fillojnë shkallët kanë një xham brenda ku punonjësit e bankës mund të fusin kartën ku publiku nuk ka akses, ndërsa pjesa tjetër është hyrja në hollet e këtij ambienti që do të jetë e hapur për publikun.

Lidhur me pyetje të tjera, zonja Dhima bëri një pyetje për ecurinë e kreditimit, unë e thashë ecurinë dhe kredinë me probleme.

Për krizën energjetike në Europë, është një çështje që me të drejtë e ngrini, është shumë problem, ne kemi varësi të madhe nga hidro, problemi kryesor është që ne kemi pjesën më të madhe të energjisë ende në prodhim hidro dhe na duhet të punojmë sa më shpejt për të ndërtuar forma alternative të prodhimit të energjisë për të shfrytëzuar energjinë diellore dhe forma të tjera, pasi thatësira ndikon. Me Ministrinë e Financave po diskutonim para një muaji për rishikimin e buxhetit dhe nevojat që do të kishte buxheti në kuadrin e krizës nga lufta, pasi edhe paketa e rezistencës kërkonte ndihma të mëdha për shtresat në nevojë. Një hall i madh ishte niveli i

baseneve të hidrocentraleve dhe nevojat që parashikonte buxheti i shtetit. Fat i madh që ra shi këto tre javë dhe u përmirësua situata energjetike dhe u rrit rezerva! Pra, jemi kaq të varur nga situata hidrike sa që duhet të gjejmë forma alternative. Kriza energjetike është një nga elementet më me risk në nivelin e çmimeve, që do të ndikojë në nivelin e buxhetit të shtetit. Po të shohim, çmimet e energjisë janë shumë të larta.

Vazhdojmë me pyetjet e zotit Xhelili, i cili pyet për inflacionin për vitin 2022.

Unë e përmenda, e parashikojmë nivelin rreth 6%, por mund të jetë edhe më i lartë. Ne e kishim parashikuar që niveli i inflacionit të dilte mbi 6% në tremujorin e katërt, ndërkohë që doli që tani. Kjo tregon që ecuria e rritjes së çmimeve po ecën më shpejt se parashikimet tona. Ne tani jemi te 6,2% dhe nuk parashikojmë që të shkojmë më tepër. Parashikimi i fundit ishte që mund të ishim mbi 6% në tremujorin e katërt të këtij viti.

Lidhur me pagat, nga informacioni që marrim nga Instituti i Statistikave, nuk kemi një parashikim për pagat, këtë mund ta dinë institucionet e riskut.

Lidhur me GDP-në, parashikohet 3,4 nga 4,2 që e kishim parashikuar dhe në 2,7 vitin që vjen nga 3,3 që ishte më parë.

Niveli i borxhit, unë e përmenda, është ulur gjatë vitit 2022 në 73,5 nga 74,5. Pra, ka pasur një ulje të nivelit të borxhit. Këto janë shifrat e konfirmuara nga Instituti i Statistikave dhe Ministria e Financave. Ne punojmë me këto shifra zyrtare dhe u referohemi në analizën tonë.

Nuk kemi një shifër tjetër të nivelit të borxhit.

(Ndërhyje pa mikrofon.)

Kjo nuk llogaritet PPP-të. Pra, niveli i borxhit pa PPP-të, pastaj kjo është çështje diskutimi, janë apo nuk janë, si do të përfshihen ato, kontabilizimi sipas standardit ndërkombëtar e të tjera.

Për sa i përket rritjes së qarkullimit të kartëmonedhës, paraja jashtë bankave rritet gjatë periudhës së krizave. Ju folët për rritjen e qarkullimit. Në fakt, ka pasur rritje të qarkullimit monetar. Ajo që ne synojmë është formalizimi, qarkullimi monetar nëpërmjet kanaleve bankare në sistem. Sa më i formalizuar, sa më i madh të jetë qarkullimi jo *cash* në ekonomi, nëpërmjet kanaleve bankare, aq më mirë është për ekonominë, për buxhetin, për individët, për formalizimin e ekonomisë, aq më pak evazion fiskal do të kishte. Amnistia fiskale në këtë kontekst shihet pozitive, sikurse e përmenda.

Ka shumë reforma, shumë masa. Përveç reformave konkrete të ndërmarra, siç janë digjitalizimi, modernizimet e sistemeve të pagesave, formalizimi i sistemit e të tjera një rol

shumë të madh ka edhe edukimi financiar. Ne bëjmë fushata për edukimin financiar, pasi ka njerëz që realisht kanë edukim të ulët dhe nuk e dinë benefitin. Pra, ne diskutojmë sot këtu, por ka zona rurale, të cilat nuk i dinë benefitet dhe duhet të informohen e të edukohen financiarisht se çfarë janë produktet bazë, çfarë është kredia, çfarë është depozita, çfarë është llogaria bankare, çfarë është kursimi dhe cilat janë benefitet. Ka një analizë të vazhdueshme të Bankës Botërore, që tregon se rritja e përfshirjes financiare, pra puna me bankat e të gjithë shoqërisë dhe individëve, zbut pabarazinë, rrit mirëqenien. Ka benefite financiare, që u shkojnë familjeve dhe individëve nga puna me këto institucione, por duhen ditur, duhen njohur produktet.

Këto kisha mbajtur shënim nga ju, zoti Xhelili.

Zoti Braçe është i fundit, zoti kryetar, se mbase u zgjatëm, por dua t'i prek të gjitha çështjet.

“A është infektuar sistemi ynë bankar nga sanksionet?”, ishte një pyetje me shumë vend nga zoti Braçe. Unë e ktheva përgjigjen. Analiza është bërë me përgjegjësi. Pra, jo vetëm analizat e aksionerëve, por kemi bërë një analizë të fundit për pasojat e krizës, që e kemi raportuar dhe u kemi dërguar informacion Kryeministrit, Presidentit të Republikës dhe Ministrisë së Financave. Në këtë kuadër, kemi të dhënat e fundit.

Për sa i përket pyetjes: “Çfarë ndikimi kanë pasur bordet mbi normën e inflacionit?”, nuk mund ta them në mënyrë teknike apo me shifra se çfarë ndikimi kanë pasur bordet mbi normën e inflacionit, por me logjikë mendoj se njëfarë kontrolli mund të ketë ndikuar në uljen e çmimeve. Informacionin e marr nga media, njësoj siç mund ta merrni ju, ose më pak se ju. Nuk e kemi këtë informacion si Bankë e Shqipërisë.

Për pyetjen: “Çfarë ndikimi ka pasur konkurrenca e munguar mbi inflacionin?”, sigurisht që konkurrenca është një element që ndikon vetëm pozitivisht. Konkurrenca është shumë e gjerë. Ne shohim funksionimin e sistemit bankar, Autoriteti i Konkurrencës pastaj ka rolin e tij. Natyrisht që ka ndikim parimisht, por nuk e them dot konkretisht me shifër se sa ndikim ka mbi inflacionin konkurrenca e shtuar ose e munguar.

Për sa u përket pyetjeve se çfarë problemi ka në strukturën e prodhimit, për politikën fiskale në sektorin bujqësor dhe si ka ndikuar inflacioni, zoti Braçe, këto janë çështje që lidhen më shumë me reformat strukturore që duhet të ndërmerren qeveria, pra jo direkt banka. Besoj se ju jeni në dijeni. Sigurisht që ne, si bankë qendrore, parimisht e kemi thënë vazhdimisht që struktura e prodhimit duhet përmirësuar, pra ne duhet ta transformojmë ekonominë tonë në

ekonomi prodhuese më shumë sesa një ekonomi të bazuar në remitanca ose në shërbime. Ky ka qenë synimi, por ky është një definicion i përgjithshëm, pasi, që të bëhet kjo, duhen reforma të thella strukturore nga të gjithë aktorët publikë, kryesisht nga qeveria. Është një sfidë e madhe afatgjatë. Sigurisht që jam dakord me ju, por konkretisht mund të flas vetëm për reformat strukturore që bëjmë ne brenda kontekstit tonë ligjor si bankë qendrore.

Po kështu, edhe për sektorin bujqësor. Natyrisht që niveli është i ulët. Ka shumë përpjekje. E fundit ishte një marrëveshje që bëmë me BERZH-in për të dhënë një fond garancie prej 100 milionë eurosh për sektorin bujqësor. Tashmë është banka “Pro Credit”, por ka dhe shumë institucione ndërkombëtare që mitigojnë riskun, që kanë skemat e mitigimit të riskut, institucione të Bashkimit European dhe të tjera si USAID-i, BERZH-i, IFC-ja, Banka Botërore, që, normalisht, duan të incentivojnë sistemin financiar për të shkuar drejt sektorit bujqësor me financime, me kredi dhe me mbështetje.

Nga ana tjetër, duhen dhe disa reforma të tjera strukturore, për ta bërë sektorin financiar më atraktiv, më kompetitiv, në mënyrë që ndërthurja e suportit me financim dhe interesit që kanë fermerët për të performuar në biznes të rezultojë produktive. Sigurisht që duhen dhe produktet. Këto janë çështje që ju i njihni më mirë. Më shumë mund të më thoni ju mua sesa unë juve për këtë fushë, pasi e keni ndjekur dhe e keni pasur në qendër të vëmendjes.

Lidhur me kredinë totale për bujqësinë, unë e dhashë shifrën dhe thamë që është e ulët.

Për sa u përket institucionet financiare jobanka, normave të interesit dhe impaktit në sektorin bujqësor, praktikisht, nga jobankat portofoli në bujqësi është 4,35%. Shoqatat e kursimit të kreditit e kanë 32,3%. Vlera totale është 4,78 miliardë lekë ose 40 milionë euro. Ky është impakti i institucioneve financiare jobanka në bujqësi. Përgjithësisht institucionet financiare jobanka janë institucione mikrokredie, por disa më të mëdha, si: “Besa”, NOA e të tjera janë të fokusuara në sektorin...

(Zoti Erion Braçe ndërhyr pa mikrofon)

Këto janë të fokusuara në sektorin...

(Zoti Erion Braçe ndërhyr pa mikrofon)

Nuk po flas për normat e interesit, por për kreditimin janë të specializuara në sektorin bujqësor. Ndërkohë, normat e interesit në kreditë konsumatore... Institucionet financiare jobanka janë institucione kreditimi.

Në radhë të parë, duhet thënë që nuk kanë depozitat e qytetarëve dhe nuk kanë të njëjtin rrezik për stabilitetin financiar si bankat.

Në radhë të dytë, duhet thënë që këto veprojnë në zona rreziku me të larta, pra kanë kredi konsumatore, që janë të pakolateralizuara dhe natyrisht që do të kenë norma interesi më të larta, sepse kudo, një kredi pa kolateral ka dhe risk më të madh moskthimi dhe ka NPL kredinë e keqe më të lartë. Nëpërmjet normës së interesit, ato mbulojnë humbjen nga moskthimi dhe pjesa tjetër e kredive më të mëdha, që janë për sektorin bujqësor dhe janë prapë në nivel mikrokredish, më e madhja quhet te niveli i SME-së, pra nuk janë kredi korporative, janë prapë brenda sektorit bujqësor, që ka risk më të lartë dhe norma e interesit është më e lartë, se ka një risk moskthimi: sezonaliteti, cilësia e pronës, analiza financiare, lodhja. Pra, në të gjithë kontekstin, natyrisht që normat e interesit duhet të jenë më të larta se të bankave, por sa? Sigurisht që jo pafund. Për këtë arsye, për t'i kufizuar, ne bëmë një rregullore, i futëm në mesataren e bankave dhe u shtuam 30%, që të mos shkojnë çmendurisht në nivele të larta dhe të abuzojnë ose të përfitojnë. Lamë mesataren e normave të interesit të tregut, pra nuk mund të jetë norma e interesit më e lartë se mesatarja e 6 muajve të tregut, plus 30% për këto, se natyrisht që kanë kredi konsumatore. Pati një reagim të fortë, që përse ndërhyri në çmime. Sigurisht, ne përdorëm standardet e Bashkimit Europian. Kjo është në fuqi nga janari i këtij viti, zbatohet dhe e kanë zbatuar. Kjo është një masë konkrete që ka marrë Banka e Shqipërisë, por, natyrisht, institucionet financiare jobanka nuk janë kaq të rregulluara sa bankat në aspektin e cilësisë, ekspertizës dhe njohurisë, por, nga ana tjetër, edhe këto kanë dhënë një kontribut konkret në ekonominë shqiptare. Zonat bujqësore, që stimulojnë bankat, i mbulojnë, e kanë një nivel kreditimi. Është detyrë e të gjitha institucioneve ligjzbatuese për të shmangur abuzimet. Nëse ka abuzime, ne i shohim. Kjo është komplekse, pra duhen parë anët e mira dhe anët e këqija në çdo lloj fenomeni.

Për sa i përket pastrimit të parave për kripton, e thashë qëndrimin tonë. E thashë qartë dhe si e shohim kripton.

Për sa i përket pyetjes së fundit, për FMN-në, zoti kryetar, se u zgjatëm...

(Zoti Erion Braçe flet pa mikrofon)

Erion Braçe – Kisha pyetje për normën fiktive të interesit, që ju e keni shpallur dhe propagandën e paguar nga institucionet financiare jobanka, që u adresohet drejtpërdrejt qytetarëve, që nuk përputhet fare me këtë normën e shpallur nga ju.

Gent Sejko – Marketingu, si i tillë, principalisht në të gjithë botën është i papërputhshëm me realitetin. Kur kam qenë në SHBA dhe në Kanada, përgjithësisht, aty ku thuhej “free” ishte më shtrenjtë se ku nuk thuhej “free”.

Nga ana tjetër, në këtë duhet ta shohim në raport me transparencën, me rregulloren e transparencës, pra me detyrimet ligjore dhe rregullative, që kanë institucionet e licencuara prej nesh, ku janë edhe këto institucione. Përfaqësuesi i drejtorisë së mbikëqyrjes është prezent. Ne jemi marrë në përgjithësi me të gjitha problematikat e institucioneve financiare jobanka. Pavarësisht se pesha është e vogël, këto institucione na kanë krijuar “kokëçarje” gjatë kësaj periudhe, por, në fakt, kjo është detyra jonë, për t’i pasur sa më të formalizuara. Është njësoj si institucionet e *Fintech*-ut, që po i licencojmë për ta shtyrë industrinë. Edhe këto institucione i kemi licencuar për t’u dhënë një impakt.

Për shembull, në momentin më të lartë të rritjes së kredive me probleme, tri ishin elementet kryesore që bankat mund të ndërmerinin për të ulur nivelin e kredisë me probleme: ristrukturimi i kredive, fshirja e kredive nga bilanci dhe shitja e portofolave, duke pasur kreditë nga bilanci. Pra, ishin tri elementet kryesore, pasi NPL-ja, nëse ju e mbani mend, kur raportoja te ju si kryetar komisioni, arriti të cenonte sigurinë kombëtare. 25% e kredisë ishte me probleme. Do të vinte një situatë falimentimesh, bankat do të kishin humbje, nuk do të kishin kapital, duke shtuar dhe krizën në Greqi dhe të gjitha elementet. Një faliment do të kthehej në një problem serioz shoqëror e social, që dihet dhe nuk ka nevojë ta them. Sigurisht që në këtë reformë ne duhet të pastronim portofolat e bankave, se kush do t’i blinte këto portofola, pasi përsëri me FMN-në bëme një forum, përsëri u lodhëm shumë me institucionet ndërkombëtare dhe nuk erdhi asnjë kompani me eksperiencë ndërkombëtare, që t’i blinte këto portofola, se ishte treg i vogël dhe nuk kishte interes. Atëherë, u detyruam t’ua jepnim kompanive shqiptare, të cilave nuk po ua përmend emrat, por ishin 4-5. Natyrisht që këto kompani shqiptare punojnë me përfitim dhe shkojnë në ekstremin e tyre, brenda kuadrit ligjor, për ekzekutimin e kolateraleve për rimarrjen e këtyre borxheve që kanë blerë nga bankat e nivelit të dytë. Shumë individë dhe biznese kanë mbi 10 vjet që nuk kanë paguar detyrimin dhe thonë: “Kam harruar që kisha një kredi 500 mijë lekë apo 5 milionë lekë në një bankë të nivelit të dytë dhe pas 10 vjetësh u kujtova”, se banka është marrë me kreditë e mëdha dhe ata mund të ketë marrë një njoftim, që nuk e kanë lexuar, kanë ndërruar adresën, për një milion arsye që ka realiteti shqiptar, dhe një ditë kanë vajtur për këtë

detyrim, që është detyrimi real i institucionit financiar dhe u thonë: “Me gjithë interesat të ka vajtur kaq”. Atëherë fillon problemi, shqetësimi. Prandaj dhe ne kemi vënë... Kjo është *de facto*.

Tani, në radhë të parë, duhet kuptuar se kushtet e kontratës duhen zbatuar. Edhe këtë e kemi kufizuar, pra përveç normës së interesit, që ishte e fundit, ne kemi kufizuar me rregullore dhe stopimin e llogaritjes së penaliteteve deri në një pikë të caktuar.

E dyta, është bërë kufizimi i normës së interesit. Ka shumë ankesa dhe shqetësime për këto raste, që gjenezën, origjinën, e kanë te mosrespektimi i kushteve të kontratës me bankat, pra te moskthimi i kredisë në bankë në një kohë *x*, por pastaj në ecuri është marrë nga institucionet financiare jobanka për të pastruar portofolat e kredisë që u bënë atëherë dhe sot kanë shpërthyer, sepse, kur ka shkelje kontraktuale, problemet duhen zgjidhur në gjyq. Natyrisht që, në qoftë se e shohim, ne i kemi marrë masat tona, janë marrë shumë masa konkrete, rregullative, ndëshkuese për institucionet financiare jobanka dhe i mbikëqyrim, por ato janë në këtë natyrë biznesi dhe kërkojnë të marrin maksimumin. Individët, në bazë të kontratës, kanë një detyrim të caktuar dhe duhet ta paguajnë. Kur kujtohen pas 10 vjetësh, atyre u duket si kredi e falur, por nuk është kështu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Ta mbarojë zoti Sejko dhe më pas keni minutazhin e fundit për komente.

Gent Sejko – Këto ishin për institucionet financiare jobanka. E thashë pak më gjerë se cilat ishin...

Erion Braçe- E fundit, ju përsëritët se do të vazhdojmë të jemi në trendin pozitiv të rritjes ekonomike, por më ulët, mbështetur në të njëjtat burime. Praktikisht, inflacioni minimalisht do të godasë konsumin. Atëherë, kjo rritja qoftë edhe 3%, në cilat burime do të mbështetet?

Gent Sejko – Përsëri ne presim rritje të konsumit, pavarësisht rënies nga ritmet e rritjes. Presim përsëri rritje të investimeve private dhe të biznesit, pavarësisht ndikimit të inflacionit në të gjithë këta faktorë. Sigurisht, një test është sezoni turistik, që mbetet për t’u parë se si do të jetë...

Erion Braçe – Kur jeni frenuar ju për godinën e dytë të Bankës së Shqipërisë, po këta nuk do të frenohen?!

Gent Sejko - Sigurisht që do të frenohen, por ne parashikojmë ta mbarojmë godinën e dytë të Bankës së Shqipërisë këtë vit. Kështu që...

Ne po themi që niveli i rritjes ekonomike do të jetë më i ulët se parashikimi, por ky është konstatimi i bankës qendrore, i ekspertëve dhe i analizave nga modeli makroekonomik dhe i politikës monetare. Ne kemi thënë në definicionin tonë që do të kemi rënie në rritjen ekonomike. Pra, rreziqet shkojnë: inflacioni për lart, rënia ekonomike për poshtë, por përsëri do të kemi rritje. Akoma jemi këtu. Ky është konkludimi i fundit sipas analizës. Nëse inflacioni do të rritet më shumë, mund të ketë dhe përkeqësim. Në fakt, të gjitha bankat qendrore të botës po i përkeqësojnë parashikimet. Se sa thellë do të shkojë përkeqësimi, këtë nuk e themi dot në këtë moment.

Për sa u përket detyrave për sistemin bankar të FMN-së, ne i kemi zbatuar dhe përgjithësisht ka vlerësime pozitive.

Zoti kryetar, këto ishin.

E fundit, kërkoj ndjesë nëse nuk i kam shifrat! Kolegët u përpoqën t'i merrnin shifrat që nuk i kisha. Për informacionin e komisionit, ne jemi të hapur që çdo informacion ta sjellim në mënyrë shkresore dhe mund t'ju vendosim në dispozicion.

Eduard Shalsi – Para se ta përmbyllim, zonja Resulaj, zoti Sinaj dhe zoti Braçe kanë tri gjëra shumë të shpejta.

Erion Braçe – Për sa i përket informacionit, do të ishte mirë të kishim analizën për bujqësinë. Më nevojitet kjo analizë.

Eduard Shalsi – Patjetër.

Gent Sejko – Zoti Braçe, do t'ju sjellim të detajuar, me shifrat që kemi.

Eduard Shalsi – Në rregull.

Fjala për zotin Sinaj.

Vullnet Sinaj – Kisha diçka për institucionet financiare jobanka.

Kuptohet që kam respekt për çdo gjë. Edhe unë do të thosha fjalët më të mira për Bankën e Shqipërisë, për ruajtjen e stabilitetit dhe në kushte të vështira, por institucionet financiare jobanka kanë krijuar probleme shumë të mëdha sociale. Takojmë përditë njerëz dhe ka raste kur ata kanë marrë 100 mijë apo 200 mijë lekë të rinj kredi dhe shifrat u kanë vajtur dyfish. Tani, çfarë ndodh realisht, pavarësisht se ato janë institucione financiare dhe kanë të drejtat e interesat e tyre: qytetarët, që shkojnë të “falen” te këto institucione financiare jobanka për të marrë kredi,

nuk shikojnë më fare nga sytë se çfarë shkruhet në kontratat e tyre dhe sa për qind kanë; janë njerëz të cilëve u duhen lekët në momentin e parë dhe mjafton t'i marrin e pastaj edhe nuk kanë ndër mend t'i paguajnë, por kjo po krijon një problem social gjithandej. Me pak fjalë, këta njerëz po humbasin gjithçka.

Unë them që të mos ekzistonin fare këto.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Radikal...

Po, zonja Resulaj.

Pranvera Resulaj- Faleminderit, kryetar!

Edhe unë në vijim të kësaj e kisha, sepse u ngacmova pak nga fjala e Guvernatorit, që tha se është marketing. Në asnjë rast këtu nuk bëhet fjalë për marketing. Jam shumë dakord me shqetësimin e zotit Braçe, sepse janë jo thjesht në nivel marketingu, por në mungesë të plotë të transparencës. Është detyrë e Bankës së Shqipërisë dhe besoj se e gjen shumë mirë veten brenda funksioneve të saj të monitorimit dhe mbikëqyrjes së transparencës së bankave të nivelit të dytë, në rastin konkret të institucioneve financiare jobankare, sepse edhe nga bankat e nivelit të dytë, në fakt, kemi pasur raste dhe eksperiencë të jetuara apo të provuara, që në termin e marketingut dhe promocionit kanë elemente të dyshimta të transparencës. Prandaj do të thosha që këto të shikohen me një sy shumë kritik, sepse, siç e thanë edhe kolegët, efekti social dhe psikologjik që shkaktojnë te njerëzit është me ndjeshmëri shumë të lartë.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Zoti Braçe.

Erion Braçe – Kam vetëm dy gjëra, edhe si reflektim kundrejt përgjigjeve.

Guvernator, unë e di fare mirë që ju merreni me reforma strukturore, që lidhen drejtpërdrejt me sektorin dhe, për të thënë të drejtën, të gjitha zhvillimet në sektor janë pozitive edhe falë udhëheqjes së Bankës së Shqipërisë, pa diskutim!

Pse kërkoj më shumë se kaq? Sepse politika e të dyja anëve shpeshherë është në presion, pastaj edhe ekzekutivi, është në presion edhe të kërkesave, që tejkalojnë nevojën, e shtyjnë nevojën përkundrejt populizimit, pa më të voglin diskutim, dhe lënë pas reforma shumë të rëndësishme, reformat strukturore.

Ju në fjalën tuaj folët për sektorin e energjisë elektrike. Diversifikimi i burimeve atje është jetik. Kur fola për strukturën e prodhimit pata parasysh ekzaktësisht edhe këtë, që pa

diskutim që ne duhet ta ndryshojmë atë strukturë prodhimi, për të shkuar drejt burimeve të tjera, që ulin varësinë tonë edhe nga kushtet klimatike apo reflektojnë ndryshimet klimatike që po ndodhin dhe i prekin të gjithë.

E njëjta gjë është në sektorin prodhues bujqësor. Pa diskutim që aty kërkohet një reformë strukturore akoma më e madhe, me qëllim që të ulim varësinë tonë qoftë nga importi, qoftë edhe nga inflacioni i importuar detyrimisht brenda vendit. Te lëndët e para, pa diskutim që kërkohet një ndryshim i strukturës së prodhimit, për sa kohë që ne tashmë jo po e kufizojmë, por po e rrisim varësinë tonë nga importi dhe nga lëndët e para dhe, për pasojë, dhe nga inflacioni i importuar edhe në prodhim. Pikërisht për këtë arsye, kërkohet që roli i Bankës së Shqipërisë të dalë përtej kornizës së sektorit, për të marrë rol udhëheqës edhe në reformat strukturore që ndikojnë në ekonomi dhe kanë impakt.

E dyta, pse e shtrova të gjithë shqetësimin e kredidhënies në sektorin e bujqësisë? Për shumë arsye.

E para, rritja e aksesit në kredi pa diskutim që do të reformojë sektorin, do të reformojë dhe strukturën e prodhimit. Me shumë sforco, politika po e çon nga prodhimi në fushë të hapur te sera, por sera 6 dynym, 7 dynym, 1 hektar, 2 hektarë, është një ndërmarrje e mesme, që rrit edhe ciklet e prodhimit, edhe sasinë e prodhimit, edhe cilësinë e prodhimeve dhe pastaj ka impaktin e vet deri në eksport. Në qoftë se hymë këtu (po flas për sistemin bankar, jo për të tjerat), sistemi bankar pa diskutim që do ta shtyjë sektorin më para. Politika e tregoi që nuk ka aq fuqi sa t'i japë një shtytje akoma më të madhe këtij sektori.

E dyta, skemat mbështetëse buxhetore janë të ngadalta, janë burokratike. Humbin ciklet e prodhimit dhe, në fund fare, janë të pamjaftueshme dhe korruptive. Tani, çfarë të them? Unë më mirë shkoj te banka, me normën mesatare që thatë ju, po marr atë më të lartën, të 6 muajve të fundit, plus 30% dhe, natyrisht, kjo është më pak se norma e ryshfetit. Në skemat buxhetore kjo është e evidente. Mjafton të flasësh me një bujk dhe e kupton fare mirë, edhe nga këta që kanë përfituar mbështetje buxhetore, jo nga ata që nuk përfitojnë dhe që e kanë perceptimin këtu brenda dhe thonë që as nuk shkoj fare atje.

Pra, hyrja e sistemit bankar në këtë pjesë pa diskutim që do të eliminonte një pjesë të madhe të korrupsionit dhe do të mbulonte një pjesë të pamjaftueshmërisë që vjen nga fondet buxhetore, që gjithmonë për bujqësinë janë të pamjaftueshme.

Natyrisht që për të këqija do të kujtohet, mbase ky do të ishte momenti për t'u kujtuar politika për buxhetin e bujqësisë, por kështu nis, duhet të ndodhë një gjë, siç ndodhi pandemia dhe dolën paratë për çdo gjë. Kishte para në sektorin e shëndetësisë në këta 2 vjet, për çdo gjë ka pasur kohë. “Duhet pajisje”; pajisjet vinin brenda 30 ditëve vinin në Shqipëri. Duheshin ilaçe, vinin; duhej rikonstruksioni i godinave, u bë. Pra, dolën paratë, u gjendën, ishin paratë.

Shpresoj shumë që kjo situatë ta bëjë politikën të reflektojë, por në bujqësi koha ka shumë rëndësi, sepse lidhet me ciklet e prodhimit. Nuk presin ciklet e prodhimit në këtë aspekt. Pikërisht për këtë arsye vazhdoj të jem shumë i interesuar në aspektin e kredisë për bujqit dhe për të ndryshuar dhe strukturën e prodhimit në bujqësi. Bujqësia gjithë kohës është konsideruar një shtëpi pa çati. Do t'i vëmë çati dhe njëri segment i çatisë është sera, fermat e mëdha me sera, për të mos folur pastaj që kemi dëme kolosale në blegtori, të cilat kanë nevojë për para. Nuk mjaftojnë paratë e buxhetit të shtetit sot që flasim për të rikuperuar dëmet që kemi marrë në blegtori në harkun e 2 vjetëve të fundit. Është një pasuri jo vetëm e fshatarëve, është pasuri kombëtare numri i bagëtive, qoftë për bulmetin, qoftë edhe për mishin.

Kështu që unë mendoj se sektori bankar mund të kompensojë një pjesë të madhe duke financuar projekte, që tashmë edhe e rikuperojnë këtë ekonomi që është dhe e strukturojnë prodhimin.

Të varemi ne nga qumështi, që duhet të na vijë nga vendet përreth nesh?! Është turp! Tani, pasi e kanë marrë atë qumështin atje, fillojnë dhe logjikojnë: “Ore, ky qumështi është me 2% yndyrë, nuk bëhet dot djathi nga ky!”.

Çfarë do të bëjmë? Do ta lëmë këtë prodhim në të tilla kushte? Jo. Atëherë, unë mendoj se sektori bankar duhet të jetë akoma më agresiv në këtë sektor.

Patjetër, qeveria duhet t'i bëjë të gjitha, por nuk është e gjithë fusha e fragmentarizuar dhe pa certifikata pronësi. Madje, nëse këto gjëra do të jenë kushte për kredinë, do t'i shtyjnë dhe të gjithë sektorët e tjerë të shërbimeve t'i bëjë ato detyra që ka qoftë në çështjen e pronësisë, qoftë edhe në çështjen e fragmentarizmit. Tani, ne nuk i bashkojmë dot më tokat, është përpjekje e kotë. Atëherë, ejani t'i bashkojmë në prodhim! Si pronësi nuk bashkojmë dot vëllain me vëllain, po jua them unë, që jam atje në fshat dhe çdo ditë takoj njerëz që më kërkojnë t'ua zgjidh unë problemin që kanë me vëllain. Nuk zgjidhet më ajo! Ejani t'i bashkojmë në prodhim. Na duhet financim për t'i bashkuar në prodhim, se 2,3,4 hektarë nuk i bën dot bujku, nuk i mbështet dot as buxheti i shtetit, duhen para të tjera.

Shumë faleminderit!

(Diskutime pa mikrofon.)

Gent Sejko – Shumë shkurt, jam dakord 100%, zoti Braçe, por edhe në këto rastet e serave, se ka pa pasur disa raste konkrete, janë pikërisht këto rreziqe, pra kolaterali, dhe banka pa kolateral nuk krediton. Rastet që janë të mira, që e kanë të kontraktuar shërbimin jashtë, produktin jashtë, sigurisht, bankat i mbështesin, por ose ka probleme me kolateralin, ose me *startup*-et, që bankat nuk i marrin parasysh, ose ka disa elemente që nuk janë njësoj si standardet e bizneseve në qytet dhe kanë disa risqe me shumë, si risku i prodhimit sezonal. Këto janë.

Erion Braçe – Guvernator, është shumë dinamike bujqësia. Për shkak të nevojës që ka për konsum, edhe për eksportet, tashmë po shkojnë grumbulluesit dhe po kontraktojnë mallin me kontrata të shkruara dhe kjo sipërfaqe që po kontraktohet po rritet. Pra, kjo lloj dinamike duhet ndjekur edhe nga sektori bankar. Është e vërtetë që para një viti mund të ketë qenë kështu, që risku ka qenë shumë i lartë, prodhimi ka qenë i pakontraktuar e të tjera me radhë, por sot që flasim, po ju them që i gjithë shalqiri i Divjakës është i kontraktuar nga qershori deri në shtator. Ata operojnë me trajlera dhe unë nuk e di nëse do të gjejmë prodhim për aq shumë. Po e humbe një treg nuk e merr dot më.

Eduard Shalsi – Folët pa mikrofon.

Duke falënderuar të gjithë kolegët për debatin dhe Guvernatorin për prezencës, ky është moment shumë i rëndësishëm për Komisionin e Ekonomisë dhe Financave dhe për parlamentin. Daljet publike të Bankës së Shqipërisë dhe të Guvernatorit përbëjnë një moment shumë të rëndësishëm për gjithkënd, duke qenë se është një institucion i cili ka konsoliduar besimin e publikut.

Nga ana tjetër, u hap çështja e bujqësisë. Në fakt, mund ta mbanim edhe 2-3 orë të tjera me historinë e deputetit Sinaj, që ka bërë një analizë me fotografi, duke regjistruar çdo lloj blegtori dhe numër krerësh. Të garantoj, zoti Spaho, se konkluzioni im i kahershëm me statistikat e bujqësisë është aq relevant sot saqë të gjitha të dhënat, të cilave u referohemi për sektorin e bujqësisë, janë më shumë çorientuese sesa orientuese, por ky është një debat që...

(Zoti Erion Braçe ndërhyr pa mikrofon.)

Patjetër. Statistikat...

(Zoti Erion Braçe ndërhyr pa mikrofon.)

Të lutem!

(Zoti Erion Braçe ndërhyt pa mikrofon.)

A të dëgjova me vëmendje? Një sekondë!

Erion Braçe – Lërë, se nuk është nevoja fare!

Eduard Shalsi – Se çfarë është e nevojshme dhe çfarë nuk është e nevojshme të them unë, e them unë. Merrni mikrofonin...

(Zoti Erion Braçe ndërhyt pa mikrofon.)

Një sekondë! E keni zakon të keq këtë, që flisni pa mikrofon! Ju flisni nga 20 minuta. Unë jam njeriu që flas më pak, duke respektuar të gjithë kolegët, ndërkohë që duket sikur cenoj. Të lutem shumë! Nuk është debat miqësor, është debat principal.

Dëgjo, zoti Spaho, se po hapim një...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E shihni se çfarë zakoni keni?!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Një sekondë!

Aftësia e Braçes për të keqkuptuar më shumë sesa për të kuptuar, në rastin konkret, është e jashtëzakonshme. Zoti Braçe, më lejo ta them këtë gjë, sepse kam përshtypjen se fole pa e pasur idenë dhe pa më dëgjuar se çfarë doja të thosha unë. Ajo që doja të thosha është pikërisht që, të dhënat, meqenëse u hap dhe është momenti të bëjmë një reflektim të thellë për statistikën e bujqësisë përgjithësisht, sepse pranohet nga Ministria e Bujqësisë ping-pongu me INSTAT-in, tashmë janë rikthyer prapë. Jemi dëshmitarë që para 15 vjetësh të dhënat ishin për të fryrë kontributin e GDP-së dhe, nëse do të duhet të bëjmë një debat real, unë e kam thënë e vazhdoj ta them që duhet të nisë edhe nga baza e të dhënave. Shpeshherë këtu na ndodh që institucioneve të ndryshme, nga dëshira për të parë shumë gjëra të ndodhin, u kërkojmë edhe gjëra që janë përtej kompetencave.

Megjithatë, unë e çmoj debatin. Siç e thashë, Guvernator i nderur dhe deputetë të nderuar, është shumë e rëndësishme dhe po bëhet gjithmonë e më e rëndësishme që kontaktet e komisionit dhe të parlamentit me Bankën e Shqipërisë të jenë të përjavshme, të përmuajshme dhe ne kemi instaluar tani një frymë dhe një urë komunikimi, për të cilën desha t'ju falënderoj, në mënyrë që shumë çështje të rëndësishme, tematika të ndryshme, që nga kriptot, një shqetësim real, e deri te bujqësia, e cila përmend, të kemi mundësi t'i ezaurojmë dhe t'i debatojmë vijueshmërisht!

Duke ju falënderuar për rolin, rishihemi nesër, në parlament, me kolegët deputetë!

MBYLLET MBLEDHJA

**Sekretare e Komisionit
Ensemvera Zake**

**Përgjegjësjë e Shërbimit të Redaktorëve
Euzheni Pengili**

**Sekretar administrativ
Elvi Prifti**